

Analiza e tregjeve me shumicë të aksesit broadband fiks

Draft konsultimi publik

Përmbajtja

Qëllimi i projekt- aktit dhe objektivat që duhen arritur	6
Çështjet kryesore të trajtuara në dokument	6
1 Prezantimi i bazës ligjore dhe strukturës së dokumentit të konsultimit publik	7
1.1 Paraqitja e fakteve, veprimeve dhe çështjeve procedurale që lidhen me përmbajtjen e projektit	7
1.2 Struktura e dokumentit të konsultimit publik	7
1 Përshkrimi i zhvillimeve broadband fiks në Shqipëri	18
1.1 Zhvillimi i aksesit në internetin broadband fiks në Shqipëri	18
1.2 Përmirësimi i normave të penetrimit broadband fiks dhe vazhdimësia e ndarjes dixhitale ndërmjet dhe brenda rajoneve	18
1.3 Panorama e ofertave të aksesit broadband fiks të disponueshme për përdoruesit fundorë	21
1.4 Tendencat teknologjike dhe rritja e fibrës si teknologjia kryesore e aksesit në Shqipëri	23
1.5 Ecuria e shpejtësisë broadband dhe rritja e përqindjes së broadband të shpejtë dhe ultra të shpejtë	25
1.6 Panorama e zhvillimeve të çmimeve të internetit	27
1.7 Zhvillimi i konkurrencës ndërmjet operatorëve nëpërmjet analizës së pjesëve të tregut	33
2 Analiza e tregjeve të infrastrukturës fizike	36
2.1 Përkufizimi i tregut	38
2.1.1 Përkufizimi i tregut të produktit	38
2.1.1.1 Mungesa e zëvendësueshmërisë ndërmjet shërbimeve aktive dhe infrastrukturës pasive	38
2.1.1.2 Mungesa e zëvendësueshmërisë ndërmjet infrastrukturës lokale dhe kombëtare	39
2.1.1.3 Zëvendësueshmëria midis tubacioneve dhe fibrës së errët	42
2.1.1.4 Zëvendësueshmëria e pjesshme ndërmjet tubacioneve dhe shtyllave	42
2.1.1.5 Mungesa e zëvendësueshmërisë ndërmjet rrjeteve të infrastrukturës fizike të ofruara nga ofruesit e komunikimeve elektronike dhe shoqëritë e tjera të utiliteteve dhe bashkitë.	43
2.1.2 Përkufizimi i tregut gjeografik	45
2.2 Panorama e kushteve të ofertës dhe kërkesës për kapacitetet me shumicë të rrjetit backbone	45
2.3 Testi i tre kritereve	49
2.3.1 Kriteri nr 1: prania e barrierave të larta dhe jo kalimtare strukturore, ligjore ose rregullatore për hyrjen në treg	50

2.3.2	Kriteri nr 2: tendenca e një strukturë tregu e cila nuk priret drejt konkurrencës efektive brenda horizontit kohor përkatës, duke pasur parasysh gjendjen e konkurrencës së bazuar në infrastrukturë dhe burimet e tjera të konkurrencës pas barrierave të hyrjes;	52
2.3.3	Kriteri nr. 3: pamjaftueshmeria e ligjit për të trajtuar në mënyrë te pershtatshme dështimin(et) e identifikuar të tregut.	52
2.4	Konkluzioni për mungesën e rëndësisë së vendosjes së rregullimit ex-ante në tregun me shumicë për infrastrukturën fizike pasive ndër-urbane	53
3	Analiza e tregjeve për shërbimet e rrjetit	53
3.1	Përkufizimi i tregut	53
3.1.1	Përkufizimi i tregut me pakicë	53
3.1.1.1	Përkufizimi i tregut me pakicë të produktit	53
3.1.1.2	Përkufizimi gjeografik i tregut me pakicë	58
	Pyetje nr.7: A jeni dakort me përkufizimin gjeografik të shërbimeve boradband me pakicë të propozuar nga AKEP në seksionin 3.1.1.2?	65
3.1.2	Përkufizimi i tregut me shumicë	65
3.1.2.1	Përkufizimi i tregut të produktit me shumicë	65
3.1.2.2	Përkufizimi i tregut gjeografik me shumicë	67
3.2	Vlerësimi i konkurrencës në tregjet përkatëse të shitjes me pakicë dhe shumicë	68
3.2.1	Vlerësimi i konkurrencës në tregjet me pakicë	68
3.2.1.1	Konkurrenca në tregun e shitjes me pakicë për shërbimet broadband për familjet	68
3.2.1.2	Konkurrenca në tregun e shitjes me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë biznes	69
3.2.2	Vlerësimi i konkurrencës në tregjet me shumicë	71
3.2.3	Identifikimi i operatorëve me një fuqi të ndjeshme në treg (FNT)	72
3.2.3.1	Asnjë dëm i konsumatorit nuk është identifikuar për shkak të mungesës së konkurrencës në rast të heqjes së rregullimit FNT në tregjet me shumicë në rrjedhën e sipërme të tregut me pakicë për shërbimet broadband për perdoruesit familjare	73
3.2.3.2	Asnjë dëm ndaj konsumatorit nuk është identifikuar për shkak të mungesës së konkurrencës në rast të heqjes së rregullimit me FNT në tregjet me shumicë në rrjedhën e sipërme të tregut me pakicë për shërbimet broadband per kategorie biznes	73
3.3	Heqja e detyrimeve ekzistuese ex-ante të vendosura aktualisht për sipërmarrësin One Albania	74
	Konkluzione finale	75
Aneks:	Standardi i rregullimit të tregjeve me shumicë të broadband fiks në Rumani, Mal të Zi dhe Francë	76
	Lista e tabelave	98
	Lista e figurave	99

Konteksti dhe baza ligjore e konsultimit publik

Qëllimi i projekt- aktit dhe objektivat që duhen arritur

Në përputhje me praktikën rregullatore Europiane dhe legjislacionin kombëtar, AKEP propozoi të ndërmarrë një rishikim të rregullimit ekzistues ex-ante të tregjeve me shumicë, për të përshtatur masat rregullatore duke marrë në konsideratë ndryshimet në produktet dhe shërbimet në dispozicion, si dhe dinamikën në zëvendësimin e produkteve nga ana e kërkesës dhe ofertës për shkak të progresit teknologjik, ecurisë në kushtet e tregut dhe zhvillimeve rregullatore.

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.9918/2008, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP-i kryen funksionet e tij në përputhje me ligjin dhe aktet e tjera nënligjore, si dhe në përputhje me politikën sektoriale kombëtare për zhvillimin e komunikimeve elektronike dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare. Ndërhyrjet e AKEP-it kryhen në respekt të parimit të asnjësisë teknologjike dhe me objektivin e nxitjes së konkurrencës efektive në ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, shërbimeve të komunikimeve elektronike, faciliteteve shoqëruese dhe shërbimeve.

Në kuadër të kompetencave të AKEP-it të parashikuara në Nenin 8 të Ligjit nr.9918/2008, Autoriteti merr masa dhe përcakton masa mbrojtëse ndaj operatorëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike për mos lejimin e praktikave antikonkurrese. Kur është e nevojshme, AKEP është gjithashtu kompetent për të përcaktuar operatorët me fuqi të konsiderueshme në treg (FNT).

Në përmbushje të objektivave të sipërpërmendur dhe duke pasur parasysh kompetencat e tij, AKEP ndërmerr në këtë dokument analizën e tregjeve broadband fikse të paraqitur për të përcaktuar tregjet përkatëse, për të vlerësuar kushtet e konkurrencës në tregjet e përcaktuara, për të përcaktuar një operator me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) dhe për të zbatuar masat rregullatore nëse është e nevojshme.

Çështjet kryesore të trajtuara në dokument

Tregjet me shumicë të aksesit broadband kanë qenë pjesë e rekomandimeve të Komisionit Europian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike të ndjeshme ndaj rregullimit ex ante që nga viti 2003. Në nivel kombëtar, bazuar në rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 "Për Analizën e Tregut", i ndryshuar, AKEP kreu analizën e tregut të tregjeve të mëposhtme:

- **Tregu me shumicë i aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA);**
- **Tregu me shumicë i aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA); dhe**
- **Tregu me shumicë i aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA).**

Këto tregje korrespondojnë me listën e tregjeve përkatëse të përfshira në rekomandimin e Komisionit Europian i vitit 2014 për tregjet e produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike të ndjeshme ndaj rregullimit ex ante si dhe lista e tregjeve në të cilat AKEP arriti në përfundimin për ekzistencën e një operatori me FNT në vendimin e saj të analizës së tregut nr. 2701, datë 22.12.2016.

Krahas tregjeve të sipërpërmendura, AKEP vlerësoi rëndësinë e vendosjes së rregullimit ex-ante në **tregun me shumicë për aksesin në infrastrukturën pasive ndër-urbane**.

1 Prezantimi i bazës ligjore dhe strukturës së dokumentit të konsultimit publik

1.1 Paraqitja e fakteve, veprimeve dhe çështjeve procedurale që lidhen me përmbajtjen e projektit

Dokumenti “Analiza e tregjeve me shumicë broadband – Dokument për Konsultimin Publik”, është hartuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullorja nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut” dhe merr në konsideratë Rekomandimet dhe Direktivat e BE-së për rregullimin e tregjeve të komunikimeve elektronike.

Në dokumentin për konsultim publik theksohen këto aspekte:

- bazën dhe praktikën rregullatore ligjore të ndjekur nga vendet e BE/BEREC dhe vendet e rajonit;
- përkufizimin e tregjeve përkatëse;
- analiza e konkurrencës në tregjet përkatëse dhe vlerësimi nëse ka operatorë me fuqi të ndjeshme në treg (FNT);
- nëse është e nevojshme, masat rregullatore të propozuara për sipërmarrësit të përcaktuar me FNT.

Ligji nr. 9918/2008, në nenin 35 të tij, parashikon procedurën e konsultimit me palët e interesuara për analizën e tregut, duke caktuar një afat prej 60 ditësh. Në të njëjtën kohë, neni 36 përcakton se AKEP gjykon, ndryshon, ruan ose heq detyrimet për FNT pas konsultimit me palët e interesuara.

Ky dokument publikohet në faqen e AKEP-it dhe palet e interesuara mund të dërgojnë komente në lidhje me konkluzionet dhe propozimet e AKEP-it duke iu referuar pyetjeve të konsultimit publik, si dhe për çdo aspekt tjetër që lidhet me këtë dokument.

1.2 Struktura e dokumentit të konsultimit publik

Dokumenti i analizës për konsultim publik është i strukturuar si më poshtë:

- Përmbledhja ekzekutive
- Prezantimi
- Kapitulli 1: Përshkrimi i zhvillimit broadband fiks në Shqipëri
- Kapitulli 2: Analiza e tregjeve të infrastrukturës fizike
- Kapitulli 3: Analiza e tregjeve për shërbimet e rrjetit
- ANEKS – Modeli Benchmark i rregullimit të tregjeve me shumicë broadband fiks në Rumani, Mal të Zi dhe Francë

Përmbledhja ekzekutive

Zhvillimi i një rrjeti broadband fiks me kapacitet shumë të lartë është një nga shtyllat kryesore që mbështet përshejtimin e dixhitalizimit të ekonomisë, si në shkallë kombëtare ashtu edhe në mbarë Evropën. Në këtë drejtim, qeveria shqiptare miratoi në vitin 2020 Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Dixhitale, duke vendosur objektivat e vendit në drejtim të vendosjes së një infrastrukture të rrjetit të komunikimeve elektronike të shpejtë dhe shumë të shpejtë në të gjithë vendin për të ndërtuar themelin për arritjen e shoqërisë gigabit-i në vitin 2025 dhe më tej.

Në hartimin e këtij plani, qeveria shqiptare përafron objektivat e saj me objektivat e Bashkimit Europian, të cilat përfshijnë, ndër të tjera, disponueshmërinë e Broadband ultra të shpejtë (të paktën 100 Mbps shpejtësi shkarkimi) deri në vitin 2025 dhe lidhjet gigabit deri në vitin 2030. Arritja e këtyre objektivave mbështetet në implementimin efikas të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet shumë të lartë të bazuara në fibra optike. Në permbushje të këtyre objektivave, legjislacioni dhe iniciativa të shumta kombëtare dhe Europiane janë implementuar në dekadën e fundit (Kodi Europian i Komunikimeve Elektronike dhe transpozimi i tij i planifikuar në ligjin shqiptar, Direktiva për Reduktimin e Kostos së Broadband dhe ligji ekuivalent i saj në nivel kombëtar (Ligji nr. 120 /2016), etj.).

Në përputhje me praktikën rregullatore Europiane dhe legjislacionin kombëtar, AKEP propozoi të ndërmarrë një rishikim të rregullimit ekzistues *ex ante* të tregjeve me shumicë për të përshtatur masat rregullatore duke marrë në konsideratë ndryshimet në produktet dhe shërbimet në dispozicion, si dhe dinamikave në zëvendësimin e produktit nga ana e kërkesës dhe ofertës për shkak të progresit teknologjik, ecurisë në kushtet e tregut dhe zhvillimeve rregullatore.

Zhvillimet kryesore të tregut broadband fiks në Shqipëri

Tregu i shitjes me pakicë për aksesin broadband fiks në Shqipëri dëshmoi një rritje të rëndësishme të volumit të linjave të shitura që nga analiza e fundit e tregut të kryer nga AKEP në 2016, pasi numri total i linjave u dyfishua (+122%), duke arritur në mbi 585 mijë lidhje aktive deri në fund të vitit 2022, krahasuar me rreth 264 mijë lidhje në vitin 2016. Kjo rritje e numrit të lidhjeve broadband shoqërohet me një rritje të normës së penetrimit kombëtar pasi kjo e fundit arriti në 81% e familjeve në 2022, nga 37% në 2016. Për më tepër, Shqipëria përmirësoi pozicionin e saj në krahasim me vendet e tjera pasi norma e penetrimit të saj në vitin 2021 ishte më e mirë se shumë vende të Evropës Lindore, pasi kishte mbetur pas tyre në vitin 2016.

Megjithatë, kjo rritje e normës së penetrimit kombëtar fsheh një ndarje të rëndësishme dixhitale që vazhdon në të gjithë territorin. Nga njëra anë, shkalla mesatare e normës së penetrimit në zonat urbane mbetet shumë më e lartë se në zonat rurale. Nga ana tjetër, brenda zonave urbane, norma e penetrimit në rajonet me popullsi të dendur (veçanërisht në Tiranë) mbetet dukshëm më e lartë se rajonet e tjera më pak të populluara.

Për sa i përket ofertës së produkteve në treg, ndërsa operatorët alternativë fitojnë gjithnjë e më shumë rëndësi, pesha e produkteve të internetit standalone u rrit me pothuajse gjysmën e abonimeve në vitin 2022, krahasuar me vetëm 30% në 2016. Përkundrazi, pjesa e shërbimeve të telefonisë zanore, shpesh të pranishme në paketat e integruara të operatorit inkumbent, vijojnë të ulen.

Përsa i përket teknologjisë, tendenca kryesore e vëzhguar është rritja e pjesës së lidhjeve me bazë fibrash, e cila u rrit nga vetëm 11% në 2016-ën, për t'u bërë në vitin 2022 teknologjia kryesore e aksesit me mbi 61% të tregut. Kjo rritje është kryesisht për shkak të zhvillimit të tregut në tërësi (rritje e normës së penetrimit, etj.), vendosjes së rrjeteve me fibra të plota nga

operatorë alternativë dhe migrimit nga teknologjitë më të vjetra (veçanërisht bakri) drejt fibrave. Ky tranzicion drejt fibrave, i cili pritet të vazhdojë edhe në vitet në vijim, çoi në disponueshmërinë e akseseve broadband me shpejtësi dhe cilësi më të mirë. Në vitin 2022, pjesa e lidhjeve broadband të shpejta dhe ultra të shpejta (d.m.th., shpejtësia e shkarkimit 30 Mbps ose më e lartë) përfaqësonte 51% të akseseve totale të ofruara në treg, krahasuar me vetëm 1% në vitin 2016.

Konkurrenca ndërmjet operatorëve është zhvilluar në tregun me pakicë. Faktorë të shumtë e tregojnë këtë zhvillim: tendenca e përgjithshme rënëse e çmimeve me pakicë (për një ofertë të caktuar) të propozuar nga operatorët kryesorë në treg, konvergjenca e çmimeve të ofruesve të ndryshëm dhe, më e rëndësishmja, ecurisë në pjesët e tregut të operatorëve të ndryshëm.

Pjesa e tregut e One Albania u përgjysmua pasi arriti vetëm 20% në 2022 krahasuar me 40% në 2017, ndërsa Vodafone u bë operatori më i madh në treg me 22% të pjesës së tregut.¹ Me zhvillimin e operatorëve më të vegjël kryesisht lokalë që kanë ndertuar rrjetin e tyre, pjesa e kombinuar e tregut të gjasthtë operatorëve më të mëdhenj në Shqipëri u ul nga 89% në 2017 në 68% në fund të 2022.

Së fundi, situata konkurruese është e ndryshme në zonat urbane në krahasim me zonat rurale. Në të parën, operatorët kryesorë që kanë mbulimin më të gjerë të rrjetit gjeografik kanë ende një prani të konsiderueshme, pavarësisht humbjes graduale në pjesët e tyre të tregut. Megjithatë, këta operatorë kanë një prani më të rrallë në zonat rurale ku ofruesit e vegjël lokalë, me shtrirje mjaft të kufizuar gjeografike, janë zakonisht të pranishëm.

Analiza e tregjeve të infrastrukturës fizike

Në vlerësimin e rëndësisë së vendosjes së rregullimit ex-ante, AKEP filloi analizën e saj duke marrë në konsideratë nëse tregjet e shitjes me pakicë do të ishin konkurruese në një situatë ku supozohet se nuk ka rregullim në nivelin e tregjeve me shumicë (kjo njihet si “Modified Greenfield Approach”). Në rast të nevojës për ndërhyrje, analiza fillon me tregun në nivelin më të sipërm, në këtë rast: tregun e aksesit të infrastrukturës fizike.

Në Rekomandimet e tij të vitit 2020, Komisioni Europian vlerësoi rëndësinë e identifikimit të një tregu të pavarur për aksesin me shumicë në infrastrukturën fizike, por më në fund zgjodhi të përfshijë aksesin në infrastrukturën fizike lokale si një masë rregullatore në tregun e aksesit me shumicë në nivel lokal. Kjo zgjedhje u motivua nga heterogjeniteti i infrastrukturës fizike në Shtetet Anëtare. Megjithatë, disa rregullatorë si ARCEP² në Francë dhe Ofcom në Mbretërinë e Bashkuar, përcaktuan një treg të pavarur të infrastrukturës fizike me shumicë.

Në përkufizimin e tregut përkatës të produktit, AKEP gjykon që tregu përkatës duhet të **përfshijë aksesin në rrjetin ndër-urban të tubacioneve dhe fibrat e errëta të ofruesve të komunikimeve elektronike**, duke përjashtuar kështu infrastrukturën fizike lokale (të cilat konsiderohen, në përputhje me praktikat aktuale kombëtare dhe Europiane, si një masë rregullatore e mundshme në tregjet e tjera me shumicë në rrjedhën e poshtme), kapacitetet aktive të transmetimit, shtyllat dhe infrastrukturën fizike të ofruara nga ofruesit e shërbimeve

¹ Sipas raportit më të fundit të tregut të AKEP për tremujorin e dytë 2023, pas integritit të abonimeve “HomeNet” të One Albania me lidhjet fikse të operatorit, One Albania rifitoi pozicionin e saj si lider në treg me 22% të pjesëve të tregut, vetëm 0,5% më i lartë se konkurrenti më i afërt, Vodafone.

² Shih seksionin 4.2 të Shtojcës.

të utiliteteve. Duke pasur parasysh shtrirjen e rrjeteve të ofruesve ekzistues (One Albania dhe ATU) si dhe natyrën e kërkesës, tregu u përcaktua, nga pikëpamja gjeografike, si **kombëtar**.

Në këtë treg janë dy ofrues kryesorë të shërbimeve me shumicë, One Albania dhe ATU. Të dy operatorët kanë një mbulim pothuajse kombëtar pasi rrjetet e tyre ndër-urbane mbulojnë rrugët kryesore dhe aktualisht u ofrojnë kërkuessve për akses shërbimin e aksesit në kapacitetet aktive të transmetimit si dhe aksesit me fibra të errëta. Pavarësisht disponueshmërisë së hapësirës në tubacione, aksesit në tubacione nuk është zhvilluar si një produkt me shumicë pavarësisht nga zbatimi i ligjit nr.120/2016 që u imponon operatorëve të rrjetit të ofrojnë akses me shumicë për kërkuessit e aksesit në kushte të drejta dhe të arsyeshme, duke përfshirë edhe çmimin. Për sa i përket fibrave të errëta, One Albania mbetet ofruesi kryesor në treg me 76% të pjesëve të tregut në vitin 2022 (duke përfshirë kapacitetet lokale dhe ndër-urbane), ndërsa ATU zë 11% të tregut me volume në rritje nga viti në vit.

Duke qenë se ky treg nuk është i përfshirë zyrtarisht në Rekomandimet e Komisionit European dhe as në Rregulloren e AKEP nr.9, duhet të kryhet testi i tre kriterëve për të vendosur nëse nevojitet një rregullim *ex-ante* në këtë treg. AKEP kreu testin e tre kriterëve dhe vlerësoi se tregu nuk e kalon testin për arsyet e mëposhtme:

- Barrierat ekzistuese ligjore dhe rregullatore, veçanërisht në lidhje me kompleksitetin e dhënies së lejeve dhe proceseve administrative shoqëruese, nuk duket se përfaqësojnë një barrierë të rëndësishme për hyrjen, veçanërisht në lidhje me i) procesin relativisht të thjeshtuar për marrjen e lejeve nga qeveria qendrore në krahasim me atë vendore, për ndertimin e rrjeteve lokale (të cilat operatorët kanë arritur t'i kapërcejnë dhe të vendosin rrjetet e tyre në nivel lokal); ii) ekzistenca e mjeteve ligjore (ligji nr. 120/2016) që i lejojnë operatorët të kërkojnë akses në rrjetet ekzistuese të One Albania dhe ATU në kushte të drejta dhe të arsyeshme (deri më sot, asnjë operator nuk ka nisur një proces për zgjidhjeje mosmarrëveshjeje përpara AKEP për evidentimin e një refuzimi të aksesit nga secili operator); dhe iii) disponueshmëria e hapësirës në tubacionet e One Albania dhe ATU.
- Mungesa e barrierave strukturore për hyrjen duke pasur parasysh kapilaritetin më të ulët të rrjetit backbone, ekzistencën e mundësive për të permbushur kërkesën në rritje për kapacitete backbone në Shqipëri, veçanërisht me zhvillimin e rrjeteve celulare (5G) (të cilat do të kërkojnë rritje të kapaciteteve backbone për të lidhur stacionet bazë) për një hyrës të ri, veçanërisht nëse kjo hyrje bëhet përmes aksesit në tubacionet e operatorëve aktuale të rrjetit.
- Pavarësisht asimetrisë në pjesët e tregut për fibrën e errët ndërmjet One Albania dhe ATU, ka elementë që tregojnë ekzistencën e një konkurrence mes të dy operatorëve, që kanë një mbulim të krahasueshëm gjeografik dhe duke marrë parasysh kërkesën në rritje për shërbimet e të dy operatorëve. Për më tepër, zhvillimi i ofertave nga ofruesit e tjerë (si OST, pavarësisht mungesës së zëvendësueshmërisë ndërmjet ofertave pasive dhe aktive) ushtron një presion konkurrues si mbi ATU ashtu edhe mbi One Albania për të propozuar oferta konkurruese.
- Duke pasur parasysh mungesën e barrierave të larta dhe jo kalimtare për hyrjen dhe konkurrencën ekzistuese direkte midis One Albania dhe ATU si dhe konkurrencën indirekte nga operatorë të tjerë të rrjetit si OST, AKEP beson se ndërhyrjet *ex-post* nga Autoriteti i Konkurrencës (AK), ose AKEP në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, duhet të jenë tëi mjaftueshme për të zgjidhur problemet e konkurrencës që mund të lindin në këtë treg.

Nisur nga sa më sipër, AKEP propozon se nuk është e nevojshme vendosja e rregullimit ex-ante në tregun e aksesit me shumicë në infrastrukturën pasive ndër-urbane.

Analiza e tregjeve për shërbimet e rrjetit

Analiza e produkteve të shërbimeve broadband me pakicë çoi në identifikimin e dy tregjeve të dallueshme të shitjes me pakicë: i) shërbime broadband për përdoruesit familjarë dhe ii) shërbime broadband për biznes. Të dy tregjet përfshijnë lidhje broadband, ose të kombinuara me shërbime të tjera si televizioni dhe telefonia zanore ose të ofruara në mënyrë të pavarur, të ofruara nëpërmjet bakrit (xDSL), fibrës optike (FTTX) ose kabllor koaksiale (coaxial cable) (HFC), pavarësisht nga niveli i shpejtësisë së ofruar.

Ky dallim bazohet në ndryshimin në natyrën e kërkesës për përdoruesit familjarë ose bizneset e vogla/të mesme me nevoja bazë, dhe ndërmarrjet ose institucionet publike/private me nevojë për një cilësi më të lartë shërbimi (latency e ulët, kohë riparimi përgjithësisht më pak se 24 orë ose 6 orë), shpejtësi simetrike të shkarkimit (download) dhe ngarkimit (upload), lidhje të tepërta për të minimizuar ndikimet e një defekti, shërbime sigurie dhe shërbime monitorimi. Kërkesa për këtë kategori të fundit përfshin edhe linja me qira në rastin e një klienti kombëtar ose ndërkombëtar me shumë vendndodhje.

Për sa i përket përkufizimit gjeografik të tregut, AKEP analizoi nëse kushtet e konkurrencës janë homogjene në 122 zona lokale. Zonë lokale përkufizohet si pjesa urbane ose rurale e secilës prej 61 bashkive të Shqipërisë. Për shkak të disponueshmërisë së të dhënave, analizat u fokusuan në ecurinë e tregut midis 2021 dhe 2022.

Pavarësisht disa dallimeve të evidentuara në zonat lokale në lidhje me numrin e operatorëve, madhësinë e tregut të adresueshëm, numrin e lidhjeve dhe dallimet socio-ekonomike në popullsinë vendase, dhe duke pasur parasysh mënyrën se si është zhvilluar konkurrenca në zona të ndryshme, AKEP nuk identifikoi barriera strukturore për hyrjen e konkurrentëve të rinj në zonat lokale. Për më tepër, prania e presionit konkurrues mbi operatorët lider në tregun lokal, veçanërisht nga operatorët me një mbulim më të gjerë gjeografik, dhe ecurinë e pjesëve të tregut të operatorëve lider lokal midis viteve 2021 dhe 2022 evidentojnë një zhvillim të konkurrencës në të gjithë territorin shqiptar. Për më tepër, mungesa e dallimeve në strategjitë e çmimeve dhe komerciale, veçanërisht nga operatorët me një mbulim të gjerë gjeografik, në të gjithë zonat lokale tregon edhe kushte të njëjta të konkurrencës. Kjo konfirmohet nga krahasueshmëria e funksionaliteteve teknike të shërbimeve të aksesit broadband në zona të ndryshme lokale.

Për sa më sipër, AKEP nuk gjykon se një përkufizim gjeografik në nivel nën-kombëtar është i përshtatshëm pasi një përkufizim i tillë nuk do të përmbushte kushtin për të pasur kufij të qartë dhe të qëndrueshëm në kohë dhe do të kërkonte analizë të thellë dhe mund të çonte në fragmentizim joefikas të tregut. Kështu, në përputhje me Rekomandimin e Komisionit Evropian 2010/572/EU datë 20 Shtator 2010 për aksesin e rregulluar në Rrjetet e Aksesit të Gjeneratës Tjetër (NGA), paragrafi 9, AKEP e gjykon të rëndësishme **ruajtjen e përkufizimit të tregut të shitjes me pakicë si kombëtar, si për shërbimet broadband fiks për kategorinë e përdoruesve familjarë ashtu edhe për kategorinë e pajtimtareve biznes.**

Në tregun e shitjes me pakicë për shërbimet e kategorisë së përdoruesve familjarë, konkurrenca është zhvilluar shumë që nga vendimi i fundit i analizës së tregut të AKEP. Duke qenë se shërbimet e aksesit për familjet përfaqësojnë mbi 90% të të gjitha shërbimeve të aksesit broadband në vend, tendencat konkurruese janë shumë të ngjashme me tendencat e përshkruara për të gjithë tregun.

Brenda tregut të shitjes me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë së biznesit, AKEP bën dallimin midis dy produkteve kryesore, shërbimit të aksesit në internet dhe shërbimeve të linjave/kapacitetit me qira. Për shërbimet e aksesit në internet të kategorisë biznes, midis 2017 dhe 2022, operatori me i madh humbi 20 pikë përqindje të pjesës së tregut, pasi zotëronte 16% në 2022. Përkundrazi, konkurrentët e tjerë, si Vodafone dhe Abissnet fituan pjesën e tregut pasi u bënë operatorët lider ne treg me përkatësisht 26% dhe 20% të pjesëve të tregut në vitin 2022.

Tregu i shitjes me pakicë për linjat me qira rezulton të jetë më pak stabil se tregjet me pakicë për aksesin në internet pasi pjesët e tregut të operatorëve rriten dhe ulen pa ndjekur një trend specifik. Kjo paqëndrueshmëri mund të shkaktohet ose nga volumet e ulëta të lidhjeve të aksesit në treg dhe/ose nga çështjet që lidhen me cilësinë e të dhënave. Në çdo rast, One Albania është operatori kryesor i linjave me qira me pakicë me një pjesë tregu që varion nga 42% në 62% gjatë periudhës midis 2017 dhe 2022.

Për të përcaktuar tregjet me shumicë në rrjedhën e sipërme të tregut të identifikuar me pakicë, AKEP gjykon të përfshijë, brenda të njëjtit treg, produkte me akses fizik dhe virtual, por të bëjë dallimin midis produkteve të aksesit lokal dhe qendror, si dhe midis produkteve me akses aktiv për tregun e përgjithshëm dhe produkte me akses aktiv me cilësi të lartë për bizneset më të mëdha dhe institucionet private/publike.

Mbi bazën e një analize të tillë, AKEP propozon që tregjet e mëposhtme, të përcaktuara në vendimin e AKEP nr. 2701, datë 22.12.2016, të mbeten përkatësisht:

- **Tregu me shumicë i aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA);**
- **Tregu me shumicë i aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA); dhe**
- **Tregu me shumicë i aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA).**

AKEP gjykon gjithashtu se të gjitha tregjet e përmendura më sipër kanë dimension kombëtar.

Volumi i produkteve të aksesit me shumicë që shiten aktualisht në Shqipëri është shumë i ulët pasi, në fund të vitit 2022, vetëm 0.1% e aksesit me pakicë në internet sigurohej përmes ofrimit në nivel shumicë. Deri në fund të vitit 2022, kishte gjithsej 578 aksese bitstream, nga 4 633 aksese në vitin 2016. Për sa i përket pjesës së tregut, numri shërbimeve të aksesit e të ofruara nga One Albania përfaqësonin 44% të akseseve totale të ofruara në 2022, që përfaqëson pjesën më të ulët të tregut të operatorit inkumbent që nga viti 2016 krahasuar me 50% të pjesës së tregut për ASC. Sa i përket numrit të akseseve lokale me shumicë, asnjë akses i plotë LLU nuk është shitur nga operatorët që nga viti 2018³.

Në menyrë të ngjashme me tregun me pakicë, edhe tregu i shitjes me shumicë për linjat me qira rezulton të jetë jo stabil pasi ecuria e volumeve totale nuk ndjek një tendencë specifike. Linjat me qira me shumicë të One Albania u ulën si në sasi ashtu edhe në pjesën e tregut midis 2017 dhe 2022 pasi ra nga 281 lidhje (43% e tregut) në 166 lidhje (13% e tregut). Përkundrazi, Vodafone u rrit si në sasi ashtu edhe në pjesën e tregut duke kaluar nga 170 lidhje (26% e tregut) në 2017 në 450 lidhje (35% e tregut) në 2022.

Për sa i përket numrit të operatorëve që kanë marrë shërbim përmes tregut me shumicë, Vodafone ishte operatori kryesor me 55 operatorë-klientë në vitin 2022 pas një rritje të ndjeshme nga vetëm 5 operatorë-klientë në vitin 2021. Abissnet është ofruesi i dytë më i madh

³ Shumë pak aksese të pjesshme ULL janë ofruar. Sipas të dhënave të operatorëve në vitin 2022, vetëm 10 aksese janë shitur në Shqipëri

me 23 operatorë-klientë në vitin 2022 (nga 17 në vitin 2021) dhe One Albania është ofruesi i tretë më i madh me 22 operatorë-klientë në vitin 2022 (në rënie nga 27 në vitin 2021).

Nisur nga sa më sipër, AKEP vëren se kërkesa për shërbime aksesit me shumicë si bitstream ose ULL është shumë e ulët ose nuk ekziston. Për më tepër, për linjat e dhëna me qira, pjesa e tregut të operatorit inkumbent është vazhdimisht në rënie dhe përfaqëson vetëm një pjesë të vogël (13%) të tregut me shumicë, pasi operatorët e tjerë patën rritje bazuar në ofertat e tyre komerciale me shumicë. Pavarësisht këtyre fakteve, konkurrenca e bazuar në infrastrukturë është zhvilluar në tregun me pakicë. Kjo tregon se, në mungesë të një rregullimi në tregun me shumicë, dëmi i konsumatorit nuk ka gjasa të materializohet në tregun me pakicë nëse hiqet rregullimi ex-ante i vendosur aktualisht për One Albania.

Për sa më sipër, AKEP propozon heqjen e të gjitha detyrimeve rregullatore të vendosura aktualisht për sipërmarrësin One Albania në tregun me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA); tregun me shumicë të aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA); dhe tregun me shumicë të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA).

Hyrje

Ndërsa kërkesa për teknologjinë dixhitale dhe aplikacionet e bazuara në internet rritet, nevoja për rrjete të komunikimit elektronik të shpejtë dhe të besueshëm bëhet një faktor kyç për rritjen ekonomike dhe dixhitalizimin e ekonomisë. Për të përgatitur dhe akomoduar këtë tranzicion dixhital, politikat kombëtare dhe Europiane po inkurajojnë vendosjen e rrjeteve të gjeneratës së re të afta për të ofruar lidhje Gigabit, si për lidhjet celulare ashtu edhe ato fikse me vendosjen e rrjeteve 5G dhe fibrave optike përkatësisht.

Në nivel European, Komisioni European ka vënë në lëvizje një plan për të arritur objektivat e mëposhtme të lidhjes deri në vitin 2025⁴:

- Rrjetet 100 Mbps që arrijnë të gjitha familjet Europiane, me mundësinë e përmirësimit të këtyre rrjeteve për të arritur shpejtësi shumë më të larta;
- Lidhja Gigabit që lidh të gjithë shtytësit kryesorë socio-ekonomikë - si shkollat, universitetet, qendrat kërkimore, qendrat e transportit, spitalet, administratat publike dhe kompanite që mbështeten në teknologjitë dixhitale - duhet të kenë akses në lidhjen gigabit;
- Mbulimi i pandërprerë 5G duhet të jetë i disponueshëm në të gjitha zonat urbane dhe të gjitha rrugët kryesore të transportit tokësor për të lidhur njerëzit dhe objektet; dhe
- Aksesit në konektivitetin e të dhënave celulare kudo, në të gjitha vendet ku njerëzit jetojnë, punojnë, udhëtojnë dhe mblidhen.

Përveç kësaj, programi i politikave të Dekadës Dixhitale të Komisionit European përcakton objektivat dixhitale të Bashkimit European për vitin 2030⁵ duke u fokusuar, ndër të tjera, në dixhitalizimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e infrastrukturës dixhitale të sigurt dhe të qëndrueshme. Objektivi i fundit përfshin një plan për të siguruar një lidhje Gigabit për të gjithë në Bashkimin European.

Për të zbatuar plane të tilla ambicioze, Bashkimi European miratoi akte të ndryshme që synojnë të mbështesin implementimin e rrjeteve të telekomunikacionit me shpejtësi të lartë duke përmirësuar kushtet ekonomike në të cilat ndërmerren investime të tilla. Tre akte janë veçanërisht të rëndësishme në këtë drejtim:

- **Direktiva (BE) 2018/19721** i Parlamentit European dhe i Këshillit të datës 11 dhjetor 2018, mbi krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike (EECC)⁶. Një nga karakteristikat kryesore të EECC është identifikimi i objektivit të promovimit të lidhjes dhe aksesit në rrjete me kapacitet shumë të lartë si një nga objektivat kryesore të rregullimit ekonomik.
- **Direktiva 2014/61/BE** i Parlamentit European dhe i Këshillit të datës 15 maj 2014 mbi masat për të ulur koston e vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë (i njohur zakonisht si Direktiva për Reduktimin e Kostos broadband,

⁴ Burimi: Komisioni European – link: <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/connectivity-european-gigabit-society-brochure#Objectives> (last access on 20/11/2023);

⁵ Burimi: Komisioni European – link: https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/europe-fit-digital-age/europes-digital-decade-digital-targets-2030_en#:~:text=Everyone%20should%20have%20access%20to,and%20to%20fair%20working%20conditions.&text=Citizens%20should%20be%20able%20to,control%20over%20their%20own%20data.&text=Digital%20devices%20should%20support%20sustainability%20and%20the%20green%20transition. (aksesi fundit ne 20/11/2023)

⁶ Burimi: Komisioni European – Link: <https://eurlex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/?uri=celex%3A32018L1972> last access on 20/11/2023).

BCRD⁷) dhe ndryshmet e tij të propozuara nga Akti i Infrastrukturës Gigabit⁸. Këto akte synojnë të ulin kostot dhe të zvogëlojnë procedurat e medha që mund të paraqesin pengesë për aksesin në infrastrukturën fizike në objektivin e ndertimit të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë.

- **Rekomandimi i Komisionit Evropian i datës 17 Dhjetor 2007** mbi tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike të justifikueshme për ndërhyrje rregullatore ex-ante ⁹(**Rekomandimet e EC-së 2007**).
- **Rekomandimi i Komisionit Evropian datë 20 Shtator 2010** për aksesin e rregulluar në Rrjetet e Gjeneratës Tjetër (NGA) (2010/572/EU), qëllimi i të cilit është promovimi i zhvillimit të tregut të vetëm duke duke rritur sigurinë ligjore dhe duke nxitur investimet, konkurrencën dhe inovacionin në tregun për shërbimet Broadband në kalimin në rrjetet NGA dhe në përcaktimin e një qasje të përbashkët për promovimin e implementimit konsistent të masave rregullatore në lidhje me aksesin NGA, duke u bazuar në procedurën e nje analize tregu.
- **Rekomandimi i Komisionit Evropian datë 11 Shtator 2013**, për detyrimet konsistente për mos-diskriminim dhe metodologjitë e kostos për promovimin e konkurrencës dhe përmirësimin e mjedisit për investimet në Broadband (2013/466/EU), qëllimi i të cilit është përmirësimi i kushteve rregullatore të nevojshme për promovimin e konkurrencës efektive, forcimi i tregut të vetëm të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, dhe nxitja e investimeve në rrjetet NGA.
- **Rekomandimi i Komisionit Evropian i datës 8 Tetor 2014** mbi tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike të justifikueshme për ndërhyrje rregullatore ex-ante ¹⁰(**Rekomandimet e EC-së 2014**).
- **Udhëzimet e Komisionit Evropian datë 7 Maj 2018**, për analizën e tregjeve dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg sipas kuadrit rregullator të BE-së për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (2018/C 159/01).
- **Rekomandimi më i fundit i Komisionit Evropian i 18 dhjetorit 2020** mbi tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike të justifikueshme për ndërhyrje rregullatore ex-ante ¹¹(**Rekomandimet e EC-së 2020**).

Objektivat dhe politikat kombëtare shqiptare për zhvillimin broadband janë në përputhje me ato të Bashkimit Evropian. Nga njëra anë, qeveria shqiptare miratoi më 3 Qershor 2020 **Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Dixhitale, Broadband 2020-2025** (me tej "Plani Kombëtar broadband") me një objektiv për t'u zhvilluar **një infrastrukturë dixhitale me shpejtësi të lartë dhe rrjet shumë të shpejtë në të gjithë vendin për të ndërtuar themelin për një shoqëri gigabit**. Se dyti, miratimi i ligjit nr. 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së

⁷ Burimi i Komisioni Evropian –

link: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=celex%3A32014L0061> (aksesi i fundit ne 20/11/2023)

⁸ Burimi: Komisioni Evropian – link: <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/gigabit-infrastructure-act-proposal-and-impact-assessment> (aksesi i fundit ne 20/11/2023)

⁹ Source: European Commission –

link: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32007H0879> (aksesimi i fundit ne 04/12/2023)

¹⁰ Burimi: Komisioni Evropian –

link: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014H0710> (last access on 04/12/2023)

¹¹ Burimi: Komisioni Evropian – link: <https://ec.europa.eu/newsroom/dae/redirection/document/72437> (last access on 20/11/2023)

kalimit” synon të lehtësojë ndërtimin e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, duke përfshirë edhe infrastrukturën fizike të ofruesve të shërbimeve të utiliteteve, që ndajnë kështu veçori të përbashkëta me direktivën e BE-së BCRD.

Në të gjitha rastet, Shqipëria bashkëpunon me Komisionin Europian për zbatimin e Kodit të Komunikimeve Elektronike Europiane (EECC) në legjislacionin e brendshëm, i cili do ta përafrojë plotësisht me politikat e Bashkimit Europian.

Në permbushje të objektivit të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) më tej Ligji 9918 (i ndryshuar), në nenin 1 të tij, që përcakton se "[Qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të neutralitetit teknologjik të nxisë konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbime të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë"]., Autoriteti Rregullator Kombëtar, AKEP, propozoi të ndërmarrë një rishikim të rregullimit ekzistues *ex ante* të tregjeve me shumicë në kuadër të zhvillimeve teknologjike dhe të tregut që kanë ndodhur në sektorin shqiptar të telekomunikacionit që nga analiza e mëparshme e tregut sipas Vendimit të AKEP nr. 2701, dt. 22.12.2016.

Në përputhje me objektivat rregullatore të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, kryerja e procesit të analizës së tregut vlerëson dhe i kushton rëndësi të veçantë respektimit të parimit të neutralitetit teknologjik dhe nxitjes së konkurrencës efektive në ofrimin e rrjeteve, shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese.

Më specifikisht, qëllimi i analizës së tregut të ndërmarrë nga AKEP është rishikimi i konkurrencës në tregjet me pakicë të shërbimeve të komunikimeve elektronike në Shqipëri dhe në përputhje me *Rregulloren nr. 9 të analizës së tregjeve sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 31 (miratuar nga Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr.747, datë 17.07.2009, si dhe ndryshuar sipas VKD nr. 2342, datë 31.07.2013)*, për të vlerësuar nëse një rregullim *ex-ante* është i justifikueshëm në listën e tregjeve në këtë rregullore.

Në rast se një ndërhyrje e tillë është e justifikueshme, AKEP do të përcaktojë nëse ka një ose disa operatorë që kanë një fuqi të ndjeshme tregu (FNT) në secilin prej tregjeve dhe, në këtë rast, të përcaktojë masat e duhura rregullatore që do të vendosen për operatorët me FNT për t'i parandaluar abuzimin me këtë fuqi. Në rast se një treg është i justifikueshëm për rregullim *ex-ante*, por nuk përfshihet në tregjet e listuara në Rregulloren Nr. 9 të AKEP, AKEP do të kryejë testin e tre kritereve për të vlerësuar nëse tregu i përcaktuar është i justifikuar për ndërhyrjen rregullatore apo jo.

Ky dokument është i strukturuar si më poshtë:

- **Seksioni 1** paraqet një përshkrim të zhvillimit kryesor të broadband fiks në Shqipëri.
- **Seksioni 2** studion rëndësinë e identifikimit të një tregu të pavarur të infrastrukturës fizike dhe vlerëson rëndësinë e vendosjes së një rregullimi *ex-ante* në tregun me shumicë për infrastrukturën fizike ndër-urbane.
- **Seksioni 3** kryen një analizë të tregjeve të shitjes me pakicë, si dhe të tregjeve të shumicës, të prekura aktualisht nga një rregullim *ex-ante* në Shqipëri.
- Pjesa e fundit e raportit ofron disa konkluzione përmbyllëse.


Së fundi, një aneks që paraqet rezultatet e një studimi benchmark të rregullimit të tregjeve me shumicë broadband fiks në Rumani, Mal të Zi dhe Francë është përfshirë në fund të dokumentit.

1 Përshkrimi i zhvillimeve broadband fikse në Shqipëri

Ky seksion do të analizojë zhvillimet kryesore të tregjeve broadband fikse në Shqipëri që nga vendimi i mëparshëm i analizës së tregut të nxjerrë nga AKEP në vitin 2016. Në veçanti, ky seksion do të trajtojë aksesueshmërinë e shërbimeve të internetit broadband fikse që nga viti 2016 (**seksioni 1.1**), ecuria e penetrimit të shërbimeve fikse të internetit broadband në vitet e fundit si për zonat urbane ashtu edhe për ato rurale (**seksioni 1.2**), produktet dhe shërbimet e ndryshme të ofruara aktualisht në treg (**seksioni 1.3**), zhvillimi teknologjik i shërbimeve fikse të internetit broadband duke theksuar zhvillimin e fibrave (**seksioni 1.4**), zhvillimi i shërbimeve të shpejta dhe ultra të shpejta broadband (**seksioni 1.5**) ecuria e çmimeve të shërbimeve të internetit broadband fikse në Shqipëri (**seksioni 1.6**), dhe pozicionimin e operatorëve të komunikimeve elektronike brenda tregut shqiptar (**seksioni 1.7**).

1.1 Zhvillimi i aksesit në internetin broadband fikse në Shqipëri

Figura 1 – Volumi i akseseve broadband fikse në Shqipëri (2016-2022)



Burimi: Raportet vjetore të statistikave të AKEP


Tregu i shitjes me pakicë për aksesin broadband fikse në Shqipëri dëshmoi një rritje të rëndësishme të volumit të linjave të odruara që nga analiza e fundit e tregut të kryer nga AKEP në vitin 2016. Siç tregohet në Figurën 1, numri i përgjithshëm i linjave është më shumë se dyfishuar (+122%) në 6 vitet e fundit pasi arriti në mbi 585 mijë lidhje aktive në fund të vitit 2022, krahasuar me rreth 264 mijë lidhje në vitin 2016, me një rritje mesatare vjetore prej 14%. Kjo rritje ka vazhduar edhe në vitin 2023 për të arritur në mbi 603 mijë linja aktive në fund të tremujorit të dytë.

1.2 Përmirësimi i normave të penetrimit broadband fikse dhe vazhdimësia e ndarjes dixhitale ndërmjet dhe brenda rajoneve

Zhvillimi i shërbimeve broadband fikse në Shqipëri mund të analizohet edhe nëpërmjet ecurisë së penetrimit të aksesit broadband në rrjetet fikse nga familjet dhe popullsia.

Siç tregohet në Figurën 2, më pak se 40% e familjeve shqiptare kishin akses në shërbime broadband fikse në vitin 2016. Kjo normë u rrit me kalimin e viteve për të arritur në 81% në fund të 2022¹²¹³.

Figura 2 - Penetrimi i aksesit broadband ne rrjetet fikse nga familjet dhe popullsia¹⁴



Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët


Siç tregohet në Figurën 3, me normë penetrimit prej 77% në vitin 2021, shkalla e normes se penetrimit të shërbimit të aksesit broadband fiks në Shqipëri rezultoi më mirë se disa vende të Evropës Lindore (Kroaci, Poloni, Lituani, Rumani dhe Bullgari), Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vende të tjera të Amerikës Latine, por mbeti më e ulët se shumica e vendeve të OECD të Evropës Perëndimore.

¹² Sipas të dhënave të raportit të INSTAT për “Përdorimi i Informacionit dhe Teknologjisë së Komunikimit tek familjet, 2023”, të publikuar në 12 Dhjetor 2023, “90.4% ose 660,136 familje kanë akses në Internet me një rrjet Broadband fiks (rrjet kabllor ose optik, ADSL, etj.), një tregues i cili është rritur me 0.1 pikë përqindje”. Burimi: https://www.instat.gov.al/media/12854/ict-2023_shqip.pdf (last accessed on 25/12/2023).

¹³ Duhet theksuar se, niveli i penetrimit për aksesin në broadband mobile me teknologjitë 3G dhe 4G arriti 77% të popullsisë (2,1 million numër i akseseve) në vitin 2022, krahasuar me 63% (1,8 million numër i akseseve) në vitin 2018. Burimi: Raporti statistikor vjetor i AKEP 2020, tabela 1, faqja 7. Link : https://akep.al/wp-content/uploads/2023/07/R2022_Treguesit-Statistikore-te-Tregut-te-Komunikimeve-Elektronike-DTMR_.pdf (page 7) (last accessed on 25/12/2023).

¹⁴ Te dhenat e popullsisë dhe familjeve sipas Census te INSTAT 2011


Figura 3 – Norma e penetrimit broadband fiks nga familjet në Shqipëri kundrejt vendeve të OECD në 2021¹⁵



Burimi: Të dhënat e AKEP për Shqipërinë. Për vendet e tjera, familjet e OECD-së me akses në internet broadband FIKS në shtëpi: https://stats.oecd.org/Index.aspx?DataSetCode=ICT_HH2 (qasja e fundit 21/11/2023)

Figura 4 evidenton progresin e bërë në Shqipëri për sa i përket penetrimit të shërbimit broadband fiks që nga analiza e mëparshme e tregut të AKEP. Në vitin 2016, me një normë penetrimi prej vetëm 37%, Shqipëria mbeti prapa të gjitha vendeve Europiane për të cilat të dhënat janë të disponueshme në bazat e të dhënave të OECD.

Figura 4 - Norma e penetrimit të shërbimit broadband nga familjet në Shqipëri kundrejt vendeve të OECD në 2016¹⁶



Burimi: Të dhënat e AKEP për Shqipërinë. Për vendet e tjera, familjet e OECD-së me akses në internet me broadband FIKS në shtëpi: https://stats.oecd.org/Index.aspx?DataSetCode=ICT_HH2 (qasja e fundit 22/11/2023)

Të dhënat e mbledhura rregullisht nga AKEP nga operatorët tregojnë se ende ekziston një hendek i madh dixhital midis rajoneve të ndryshme, si dhe midis zonave urbane dhe rurale


¹⁵ Të dhënat për familje dhe popullsinë bazuar ne Censusin INSTAT 2011

¹⁶ Vetem vendet me te dhena te disponueshme per vitin 2021 jane perfshire ne Figuren 4

brenda rajoneve. Deri në fund të vitit 2022, vetëm kryeqyteti i Tiranës përbënte 45% të numrit të akseseve me pakicë të ofruara në Shqipëri. Për më tepër, rreth 80% e akseseve me pakicë u ofruan në zonat urbane që përfaqësojnë 64% të popullsisë¹⁷, ndërsa zonat rurale që përfaqësojnë 36% të popullsisë përbënin vetëm 20% të akseseve në shërbimin broadband fiks.

Çështja e ndarjes dixhitale midis zonave rurale dhe urbane është identifikuar në planin kombëtar të qeverisë për broadband¹⁸ në të cilën qeveria vlerësoi se në vitin 2019 "pothuajse 90% e totalit të lidhjeve fikse janë në zonat urbane dhe 10% në zonat rurale". Kështu, hendeuku midis zonave urbane dhe rurale është zvogëluar midis 2019 dhe 2022 pasi përqindja e lidhjeve në zonat rurale u rrit nga 10% në 20%. Pavarësisht këtij përmirësimi, ndarja dixhitale midis zonave urbane dhe rurale mbetet e lartë.

Figura 5 - Norma fikse e penetrimit broadband sipas popullsisë, sipas rajonit në 2022



Burimi: Raporti vjetor i statistikave të AKEP, 2022 (Figura 9, faqe 16)

Qëndrueshmëria e një ndarjeje të tillë është evidentuar edhe nga AKEP. Siç tregohet në figurën 5 më sipër, shkalla mesatare e penetrimit sipas popullsisë në zonat urbane (31%, e përfaqësuar nga vija horizontale e gjelbër) është 3 herë më e lartë se në zonat rurale (9%, e përfaqësuar nga vija blu horizontale)¹⁹. Edhe brenda zonave urbane, ekziston një hendek i madh midis rajoneve. Për shembull, niveli i penetrimit sipas popullsisë në zonat urbane të Tiranës (mbi 46%) është dukshëm më e lartë se në zonat urbane të Dibrës (rreth 13%).

1.3 Panorama e ofertave të aksesit broadband fiks të disponueshme për përdoruesit fundorë

Operatorët e komunikimeve elektronike propozojnë disa shërbime për klientët e tyre me pakicë, duke filluar nga shërbimet standalone të aksesit në internet deri tek paketat e shërbimeve të integruara trefishe ose katërfishe. Ndërsa telefonia zanore fikse zvogëlohet në


¹⁷ Burimi Macrotrends në 2020: <https://www.macrotrends.net/countries/ALB/albania/rural-population#:~:text=Albania%20rural%20population%20for%202021,a%203.16%25%20decline%20from%202020> (qasja e fundit më 01/12/2023)

¹⁸ Shih Figurën 7 Planit Kombëtar Broadband

¹⁹ Sipas vlerësimeve paraprake, norma e penetrimit nga familjet në zonat urbane në fund të tremujorit të dytë të 2023 ishte 87%, krahasuar me 45% zonat rurale.

përdorim dhe abonim, pjesa e paketave, duke përfshirë shërbime të tjera, rritet në rëndësi me kalimin e kohës.


Figura 6 – Pjesët e ofertave të ndryshme fikse të paketuara dhe të ndara duke përfshirë një shërbim aksesi në internet në 2022



Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP

Figura 11 tregon se ofertat që nuk kanë telefoninë zanore (d.m.th. ofertat standalone internet dhe internet + TV) përfaqësonin 72% të totalit të ofertave broadband në Shqipëri deri në fund të vitit 2022, nga vetëm 37% në 2016. Ky trend duket se do të vazhdojë pasi, në fund të tremujorit të dytë të 2023, pjesa e ofertave që përjashtojnë telefoninë zanore arriti në 73%.

Figura 7 – Përbërja e paketave të shërbimeve fikse të operatorëve në vitin 2022



Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP

Operatorët e sektorit të telekomunikacionit janë pozicionuar ndryshe në lidhje me paketat e shërbimeve fikse të ofruara aktualisht në treg. Siç tregohet në Figurën 7, deri në fund të vitit 2022, oferta kryesore e operatorit One Albania mbetet *paketa trefishe* (53%), me kombinimin e shërbimit të telefonisë zanore dhe aksesit në internet e dyta më e përdorura nga pajtimtarët

e One Albania (43%). Kjo tregon se telefonja zanore vazhdon të jetë pjesë strukturore e paketave të One Albania.

Përkundrazi, pjesa më e madhe e ofertave broadband fiks të Vodafone nuk përfshin telefoninë zanore pasi dy paketat kryesore me abonim nga pajtimtarët e Vodafone janë interneti + TV (52%) dhe shërbimi i aksesit standalone në internet (47%).

Oferta kryesore e Albanian Satellite Communications (ASC) është paketa e internetit + telefonisë zanore, e cila përfaqëson pothuajse gjysmën e paketave të këtij operatori. Përveç kësaj, 25% e përdoruesve të ASC janë të abonuar në paketën internet + TV.

Për operatorët e tjerë që së bashku përbëjnë 72% të totalit të abonimeve, shërbimi i aksesit të internetit standalone është oferta kryesore në të cilën përdoruesit fundorë janë të abonuar, duke përfshirë telefoninë zanore që përfaqëson vetëm 6%.

1.4 Tendencat teknologjike dhe rritja e fibrës si teknologjia kryesore e aksesit në Shqipëri

Figura 25 – Harta e rrjetit të fibrave optike të One Albania në Shqipëri



Burimet: AKEP ATLAS bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët (aksesimi i fundit më 29/11/2023)

Figura 25 tregon situatën aktuale të rrjetit të fibrave optike të One Albania në Shqipëri. Sipas informacionit të publikuar nga One Albania⁴², rrjeti i fibrave optike të operatorit mbulon 5 400 km. Ai përbëhet nga dy segmente kryesore: i) rrjeti lokal dhe ii) rrjeti në distanca të gjata.

Rrjeti lokal i One Albania aktualisht është ndërtuar në dy tipologji:

- një rrjet me bazë bakri me topologjinë Fiber to the Cabinet (FTTC), me një segment fibër optike (në pronësi të One Albania dhe i vendosur në tubacionet e veta) nga zyra qendrore në kabinetin e rrugës, dhe një segment bakri nga kabineti në ambientet e përdoruesit fundor. Segmenti i bakrit i rrjeteve FTTC të One Albania mbulon mesatarisht rreth 500 metra dhe është i kufizuar në 1 km.
- një rrjet fibër i ndërtuar së fundmi me një topologji Fiber deri ne shtëpi (FTTH). Ky rrjet bazohet në teknologjinë GPON dhe së fundmi në XGPON. Rrjeti FTTH i One Albania është ende në ndërtim e sipër dhe nuk ka ende të njëjtin mbulim të gjerë si rrjeti FTTC.

Rrjeti në distanca të gjata të One Albania është ndërtuar tërësisht me fibra optike me kapacitet 96 fibra, dhe në pak raste 48 fibra, në infrastrukturën nëntokësore të ndërtuar përgjatë autostradave kryesore. Ky rrjet është i ndërtuar në sisteme unazore, duke kufizuar kështu mundësinë e ndërprerjeve të shërbimit. Pikat e interkoneksionit në rrjetin backbone të One

⁴¹ Sipas INSTAT, numri total i familjeve në Shqipëri ishte 758 973. Link :<https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-nj%C3%ABsive-ekonomike-familjare/publikimet/2023/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-nj%C3%ABsive-ekonomike-familjare-2022/> (qasja e fundit më 04/12/2023)

⁴² Faqja e internetit e One Albania, linku:<https://www.one.al/en/One-Network> (qasja e fundit më 30/11/2023).

Albania janë të pranishme në shumicën e qendrave urbane, One Albania zotëron pjesën më të madhe të rrjetit të saj backbone, me përjashtim të disa segmenteve.


Albanian Telecommunication Union (ATU)

ATU është një operator kryesisht me shumicë me një aktivitet të përqendruar rreth rrjetit në distanca të gjata. Pas blerjes së Digicom nga ATU në vitin 2019, ndërkohë që të dy entitetet mbeten të ndara nga pikëpamja operationale, ATU filloi zhvillimin e rrjetit të saj lokal duke vendosur një rrjet fibër në disa zona urbane. Megjithatë, aktiviteti kryesor i ATU-së si ofrues me shumicë mbetet i fokusuar në rrjetin në distanca të gjata.

ATU filloi aktivitetin e saj në Shqipëri në vitin 2010 me Urdhrin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit nr. 120, datë 23.08.2010, për dhënien e lejes ATU për ndërtimin e rrjetit me fibra optike në akset kombëtare të Republikës së Shqipërisë. Kushtet fillestare të kësaj leje përcaktonin se:

- ATU do të ndërtojë një rrjet me fibra optike në akset kryesore rrugore kombëtare;
- ATU do të instalojë 6 kablllo/fibra optike, nga të cilat 2 janë për përdorim nga vetë ATU dhe 4 janë te lira për përdorim nga operatorë të tjerë, të palidhur me ATU;
- ATU i paguan shtetit shqiptar pagesa vjetore prej 4% të të ardhurave të realizuara nga përdorimi i infrastrukturës së instaluar;
- Operatorët e tjerë që përdorin kablllo optike te lira paguajnë 6% të të ardhurave të tyre, por jo më pak se 330 mijë euro në vit;
- Në rast dështimi të negociatave (afati 3-mujor) për tarifën ndërmjet ATU dhe operatorit tjetër, mosmarrëveshja do të zgjidhet vetëm nga Gjykata e Tiranës.
- Afati i lejes për ATU është 20 vjet me të drejtë rinovimi për 20 vjet të tjera.

Figura 26 – Harta e rrjetit të fibrave optike të ATU në Shqipëri



Burimet: AKEP ATLAS bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët (aksesimi i fundit më 29/11/2023)

Që nga dhënia e lejes së saj, ATU zgjeroi rrjetin e saj fillimisht duke ndërtuar një rrjet prej 750 km fibër që mbulonte qytetet kryesore dhe vendet kufitare, më pas duke zgjeruar rrjetin për të siguruar lidhje me stacionet bazë celulare dhe për të mbuluar bashkitë lokale. Aktualisht, sipas vlerësimeve të ATU, rrjeti i fibrave optike të operatorit mbulon 2500 km.


Ofertat kryesore me shumicë të disponueshme aktualisht për kapacitetet backbone në Shqipëri janë linjat aktive me qira dhe fibrat e errëta. ATU u ofron kërkueseve të aksesit pika interkoneksioni çdo 1 km përgjatë rrjetit të saj.

Operatorë të shumtë aktualisht ofrojnë oferta me shumicë backbone të linjave me qira. Ofruesit kryesorë janë One Albania, ATU dhe OST.

OST

OST është një subjekt shtetëror përgjegjës për rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike. Krahas përgjegjësive të saj kryesore, OST është i angazhuar në mënyrë aktive në tregun e komunikimeve elektronike, pasi ofron, që prej vitit 2021, kapacitete me shumicë të transmetimit të të dhënave, nëpërmjet linjave aktive me qira të ofruara nëpërmjet një teknologjie DEDM, për operatorët kombëtar dhe ndërkombëtar të telekomunikacionit.

Figura 27 – Harta e rrjetit të fibrave optike të OST-së në Shqipëri




Burimet: AKEP ATLAS bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët (aksesimi i fundit më 29/11/2023)

OST ka ndërtuar rrjetin e saj me fibër krahas rrjetit ekzistues të transmetimit të energjisë elektrike, veçanërisht linjat 110 Kv, 150 Kv, 220 Kv dhe 400 Kv. OST ka instaluar rreth 20 nje DEDM dhe është e pranishme në 53 stacione në të cilat mund të ofrojë shërbime të dhënash të Layer 2. Në përgjithësi, OST ka shpërndarë 2000 km fibra, duke mbuluar sipas vlerësimeve të OST, 75% të territorit shqiptar.

One Albania dhe ATU janë operatorët kryesorë që aktualisht ofrojnë fibër të errët në Shqipëri.

Figura 28 – Volumet e fibrave të errëta me shumicë (në km) në Shqipëri 2018-2022



Burimet: Të dhënat e AKEP-it të mbledhura nga operatorët

Figura 28 tregon se interesi për fibrat e errëta po rritet në Shqipëri nga operatorët. Midis 2018 dhe 2022, volumi i përgjithshëm i fibrave të errëta të ofruara përmes tregut me shumicë u rrit me 63%, nga 1 809 km në 2 943 km. Kjo rritje është kryesisht për shkak të One Albania, e cila pothuajse dyfishoi kapacitetet e saj me shumicë të fibrave të errëta midis 2018 dhe 2022 dhe rriti pjesën e saj të tregut me 10 pikë përqindje nga 66% në 76%. ATU ka rritur gjithashtu kapacitetet e saj të fibrave të errëta nga 137 km në 325 km (+137%) midis 2018 dhe 2022 për të zënë 11% të aksioneve të tregut.

Siç tregohet në Figurën 23, kërkesa për kapacitete tubacionesh në Shqipëri nuk është zhvilluar në vitet e fundit. Nga njëra anë, One Albania, ofruesi kryesor i kapaciteteve të tilla (me 92% të pjesëve të tregut në vitin 2022), siguron një volum kapacitetesh në rënie çdo vit. Nga ana tjetër, ATU aktualisht nuk ofron asnjë kapacitet të tubacioneve në tregun me shumicë. Megjithatë, të dy operatorët kanë hapësirë të lirë në tubacionet e tyre që mund të përdoret nga operatorë të tjerë ose për të vendosur fibrat e tyre ose për të marrë me qira fibra të errët.

Pyetje nr.3: A keni komente për kushtet e ofertës dhe kërkesës për kapacitetet backbone me shumicë të paraqitura në seksionin 2.2?

2.3 Testi i tre kriterëve

Sipas nenit 67 të Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike dhe nenit 31 e vijues të kreut VI të ligjit 9918 në Shqipëri, autoriteti rregullator kombëtar duhet të justifikojë vendosjen e detyrimeve rregullatore ex-ante nëse plotësohen tre kriteret e mëposhtme:

- janë të pranishme barriera të larta dhe jo kalimtare strukturore, ligjore ose rregullatore për hyrjen;

- **ekziston një strukturë tregu e cila nuk priret drejt konkurrencës efektive brenda horizontit kohor përkatës, duke pasur parasysh gjendjen e konkurrencës së bazuar në infrastrukturë dhe burimet e tjera të konkurrencës pas barrierave të hyrjes;**
- **Vetëm ligji i konkurrencës është i pamjaftueshëm për të trajtuar në mënyrën e duhur dështimin(et) e identifikuar(a) të tregut.**

Autoriteti rregullator kombëtar mund të mos kryejë këtë test me tre kritere nëse tregu në fjalë është përfshirë në rekomandimin e Komisionit Evropian dhe konsideron se këto kritere janë përmbushur.

Duke pasur parasysh se tregu me shumicë për aksesin pasiv në infrastrukturën fizike ndërrurbane (siç përcaktohet në seksionin 2.1) nuk është pjesë as e rekomandimit të Komisionit Evropian dhe as e ligjit shqiptar që specifikon tregjet e përjashtuara nga testi i tre kritereve, ky i fundit është kryer më poshtë.

2.3.1 Kriteri nr 1: prania e barrierave të larta dhe jo kalimtare strukturore, ligjore ose rregullatore për hyrjen ne treg

Dy operatorë kryesorë janë aktualisht të pranishëm në tregun me shumicë të infrastrukturës pasive ndërrurbane. Siç tregohet në Figurën 24, Figura 25 dhe Figura 26, të dyj operatorët kanë një rrjet me shtrirje të gjerë kombëtare që mbulon akset kryesore ndërrurbane.

Hyrja në këtë treg për një konkurrent të ri që dëshiron të ndërtojë një rrjet me një mbulim të krahasueshëm gjeografik mund të pengohet nga sfidat ligjore dhe rregullatore. Në fakt, ndërtimi i rrjeteve kombëtare kërkon dhënien e lejeve dhe miratimeve administrative kryesisht nga pushteti qendror. Në të vërtetë, hyrja e ATU në treg në vitin 2010 u lehtësua nga Urdhri i Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit nr. 120, datë 23.08.2010. Sigurimi i lejeve të tilla përfaqëson kështu pengesën e parë dhe kryesore rregullatore/ligjore me të cilën duhet të përballen hyrësit e rinj.

Aktualisht, ekzistojnë mjete të shumta ligjore dhe iniciativa rregullatore që synojnë të lehtësojnë vendosjen e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë në Shqipëri, duke përfshirë rrjetin backbone.

Ligji nr.120/2016 përcakton kuadrin ligjor në lidhje me procedurat dhe afatet kohore për dhënien e lejeve. Në rast se qeveria qendrore është autoriteti kompetent për dhënien e lejeve të kalimit, vendimi për dhënien ose refuzimin e lejes duhet të merret brenda 30 ditëve brenda marrjes së një kërkesë të plotë (neni 31(4)). Ky afat kohor është në përputhje me nenin 7 të BCRD i cili citon se “*Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme, për të siguruar që autoritetet kompetente të japin ose refuzojnë lejet brenda katër muajve nga data e marrjes së një kërkesë të plotë për leje, pa paragjykuar afatet ose detyrimet e tjera specifike të përcaktuara për kryerjen e duhur të procedurave që janë të zbatueshme për procedurën e dhënies së lejes [...]” dhe është vlerësuar kështu si e arsyeshme.*

Palët e interesuara shprehën mungesën e kënaqësisë në lidhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e procesit të marrjes së lejeve të ndërtimit, të aksesit dhe ndarjes së infrastrukturës ekzistuese, gjë që vë në dukje një zbatim joefikas të mundshëm të ligjit nr.120/2016. Megjithatë, duhet theksuar se procedurat për ndërtimin e rrjetit në nivel lokal janë të ndryshme nga procedurat për ndërtimin e një rrjeti kombëtar. Dallimi kryesor është se i pari zakonisht trajtohet nga pushteti vendor dhe tjetri trajtohet nga qeveria qendrore. Procedurat e trajtuara nga qeveria qendrore janë shpesh më të thjeshta dhe nuk paraqesin disa nga

problemet me të cilat përballen operatorët në rastin e procedurave të trajtuara nga pushteti vendor.⁴³ Pavarësisht nga kompleksiteti i procedurave administrative dhe të dhënies së lejeve të trajtuara në nivel lokal, shumë operatorë të madhësive të ndryshme kanë mundur të ndërtojnë rrjetin e tyre duke çuar në një konkurrencë të bazuar në rrjet në tregun me pakicë. Gjithashtu, nisma të shumta bashkëpunimi midis AKEP-it dhe qeverisë qendrore dhe vendore për përmirësimin e procedurave dhe vonesave të dhënies së lejeve janë në vazhdim e sipër, gjë që sinjalizon përmirësime të mëtejshme në procesin e dhënies së lejeve.

Si rezultat i analizës së të gjithë këtyre elementeve të kombinuara, AKEP gjykon se nuk konstatohet ekzistenca e barrierave të larta dhe jo kalimtare ligjore dhe rregullatore për hyrjen.

Për më tepër, AKEP beson se tregu nuk paraqet barriera strukturore për hyrjen. Në të vërtetë, kapilariteti i rrjetit backbone është shpesh më i ulët se rrjeti lokal, një segment në të cilin konkurrenca e bazuar në infrastrukturë tashmë është zhvilluar. Ky kapilaritet i reduktuar shpesh shoqërohet me një kosto më të ulët të shfrytëzimit. Kjo pikëpamje mbështetet më tej nga ekzistenca e një kuadri të konsoliduar rregullator që lejon ndarjen e infrastrukturës fizike ndërmjet operatorëve, qoftë nëpërmjet kërkesave për akses apo marrëveshjeve të bashkëinvestimit. Rregullore të tilla, duke përfshirë Vendimin nr. 190/ 2022 që ndryshon rregullat për shpërndarjen e kostove në lidhje me koordinimin e punës inxhinierike, sigurojnë që vendosja e infrastrukturës fizike (ose përdorimi i infrastrukturës ekzistuese për vendosjen e fibrave) të jetë i arsyeshëm dhe i drejtë.

Për më tepër, duke pasur parasysh kërkesën në rritje për kapacitete backbone në Shqipëri, veçanërisht me zhvillimin e rrjeteve celulare (5G) (të cilat do të kërkojnë rritje të kapaciteteve backbone për të lidhur stacionet bazë), një hyrës i ri mund të kapë një pjesë të kërkesës ekzistuese dhe të re për kapacitete në tubacione ose fibër të errët.

Në të gjitha rastet, ndërkohë që aksesin në tubacion nuk është zhvilluar si produkt për rrjetin core, kjo nuk tregon domosdoshmërisht se një akses i tillë është i pamundur. Në të vërtetë, siç u përmend më lart, evidencat tregojnë se si ATU ashtu edhe One Albania kanë kapacitete të lira në tubacionet e tyre dhe u është kërkuar të ofrojnë akses në tubacionet e tyre për kërkuesit e aksesit sipas kushteteve të përcaktuara në ligjin nr.120/2016, edhe pse nuk janë përcaktuar si operatorë me FNT në këtë treg.

Vlen të theksohet se asnjë kërkues aksesin nuk ka nisur një proces zgjidhjeje mosmarrëveshjeje në lidhje me një refuzim abuziv të një kërkesë për akses në tubacion tek AKEP. Prandaj, duke fituar akses në kapacitetet e One Albania dhe/ose ATU, një operator mund të ofrojë një ofertë konkurruese me shumicë me fibra të errëta në një periudhë të arsyeshme të shkurtër kohore dhe me një kosto të arsyeshme.

Si rezultat i analizës së të gjithë këtyre elementeve të kombinuara, AKEP gjykon se nuk konstatohet ekzistenca e barrierave strukturore të larta dhe jo kalimtare për hyrjen.

AKEP vlerëson se kriteri nr.1 nuk plotësohet.

⁴³ Probleme të tilla mund të përfshijnë: mungesën e inventarizimit të plotë të infrastrukturës pasive ekzistuese të bashkive për ripërdorim për brez të gjerë dhe mungesën e organizimit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore mes disa projekteve të ndërtimit të rrugëve, duke çuar në vonesa të mëdha në dhënien e lejeve. Burimi: Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Dixhitale, Broadband 2020-2025.

2.3.2 Kriteri nr 2: tendenca e një strukturë tregu e cila nuk priret drejt konkurrencës efektive brenda horizontit kohor përkatës, duke pasur parasysh gjendjen e konkurrencës së bazuar në infrastrukturë dhe burimet e tjera të konkurrencës pas barrierave të hyrjes;

Ndërkohë që ekzistojnë dy konkurrentë në treg (One Albania dhe ATU) për infrastrukturën pasive ndërrurbane me shumicë, ekziston një hendek i rëndësishëm në pjesët e tregut midis të dy operatorëve. Siç tregohet në Figurën 28, në vitin 2022, pjesa e tregut të One Albania përfaqësonte 76% të volumit total të fibrave të errëta me shumicë (lokale + ndërrurbane) krahasuar me vetëm 11% për ATU. Përveç kësaj, midis dy konkurrentëve, vetëm One Albania ofroi akses në tubacione për operatorët e tjerë (lokal + ndërrurban).

Pavarësisht kësaj asimetrie në pjesët e tregut, ka elementë që tregojnë ekzistencën e konkurrencës mes të dy operatorëve. Së pari, siç shpjegohet në seksion 2.2, rrjetet e të dy operatorëve mbulojnë akset kryesore dhe u ofrojnë kërkuesve te aksesit një mbulim rrjeti të krahasueshëm. Së dyti, volumet e fibrave të errëta të ofruara nga të dy operatorët po rriten, gjë që evidenton se kërkuesit e aksesit në nivel total nuk preferojnë në mënyrë strikte ofertën e njërit kundrejt ofertes së operatorit tjetër. Kjo pikë i është konfirmuar AKEP-it nga operatorë të shumtë, të cilët i konsiderojnë ofertat e të dy operatorëve kryesisht si zëvendësues dhe, deri diku, plotësues të njëri-tjetrit për të siguruar backup në segmentet e rrjetit ku të dy janë të pranishëm dhe/ose për të fituar akses të plotë në rast të pranisë së një ofruesi të vetëm. Së treti, disponueshmëria e kapacitetit të lirë në rrjetin e ATU i jep operatorit më shumë fleksibilitet në përcaktimin e strategjisë së tij tregtare dhe të çmimeve, pavarësisht nga One Albania. Si e tillë, konstatohet evidenca e një konkurrence efektive midis të dy operatorëve.

Për më tepër, zhvillimi i produkteve të linjave aktive me qira nga operatorë alternativë të rrjetit, si OST, ushtron presion konkurrues si mbi ATU ashtu edhe mbi One Albania për të propozuar oferta konkurruese. Në të vërtetë, pavarësisht mungesës së zëvendësueshmërisë midis ofertave pasive dhe aktive, si dhe midis ofertave nga operatorët e telekomunikacionit dhe operatorët e utiliteteve, ekzistenca e një oferte nga një operator alternativ në treg luan një rol të rëndësishëm në kufizimin e aftësisë së One Albania ose ATU për të adoptuar një sjellje antikonkurruese.

Si rezultat i analizës së të gjithë këtyre elementeve të kombinuar, AKEP vlerëson se ka mungesë të evidencave që mbështesin se struktura e tregut nuk priret drejt konkurrencës efektive brenda horizontit kohor përkatës.

AKEP vlerëson se kriteri nr.2 nuk plotësohet.

2.3.3 Kriteri nr. 3: pamjaftueshmeria e ligjit për të trajtuar në mënyrë te pershtatshme dështimin(et) e identifikuar të tregut.

Nga karakteristikat e tregut të shpjeguara më sipër, AKEP nxjerr se ndërhyrjet ex-post nga Autoriteti i Konkurrencës (AK), ose AKEP në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, duhet të jenë të mjaftueshme për të adresuar problemet e aksesit në infrastrukturën pasive ndërrurbane të rrjeteve të komunikimeve elektronike në Shqipëri.

Në përputhje me objektivin final për të garantuar interesat e përdoruesve fundorë në tregun me pakicë, në të cilin është zhvilluar një konkurrencë e bazuar në infrastrukturë, AKEP beson se futja e detyrimeve rregullatore ex-ante në një treg aktualisht të parregulluar në rrjedhën e sipërme nuk është i nevojshëm.

AKEP vlerëson se kriteri nr.3 nuk plotësohet.

Pyetje nr.4: A jeni dakort me analizën e AKEP për testin e tre kritereve për tregun me shumicë për infrastrukturën fizike pasive ndër-urbane të paraqitur në seksionin 2.3?

2.4 Konkluzioni për mungesën e rëndësisë së vendosjes së rregullimit ex-ante në tregun me shumicë për infrastrukturën fizike pasive ndër-urbane

Në mënyrë të përmbledhur, duke pasur parasysh mungesën e barrierave të larta dhe jo kalimtare të hyrjes, mbi tendencën drejt konkurrencës efektive dhe mbi mjaftueshmërinë e ligjit të konkurrencës në vetvete për të adresuar dështimet e vazhdueshme të tregut, AKEP propozon që nuk është e përshtatshme futja e rregullimit *ex-ante* në tregun me shumicë për infrastrukturën pasive ndër-urbane.

Pyetje nr.5: A jeni dakort me konkluzionin e AKEP në lidhje me mungesën e nevojës për vendosjes së rregullimit ex-ante në tregun me shumicë për infrastrukturën fizike pasive ndër-urbane?

3 Analiza e tregjeve për shërbimet e rrjetit

3.1 Përkufizimi i tregut

Qëllimi kryesor i rregullimit ekonomik është të mbrojë interesat e përdoruesve fundorë duke parandaluar aktorët ekonomikë që zotërojnë një fuqi të caktuar tregu që të abuzojnë me këtë fuqi në dëm të konsumatorëve. Siç specifikohet në paragrafin 6 të Rekomandimeve të KE-së 2020 “[t] objektivi përfundimtar i ndërhyrjes rregullatore është të prodhojë përfitime për përdoruesit fundorë në aspektin e çmimit, cilësisë dhe zgjedhjes duke arritur konkurrencë të qëndrueshme në nivelin me pakicë.”. Për këtë arsye, identifikimi i tregjeve në të cilat mund të justifikohet rregullimi ex ante fillon me analizën e situatës konkurruese në tregjet me pakicë për të vlerësuar nëse në mungesë të ndërhyrjes rregullatore në tregjet e sipërme me shumicë do të zhvillohet konkurrenca ose jo.

3.1.1 Përkufizimi i tregut me pakicë

Në përputhje me praktikën rregullatore Europiane, pikënisja e një analize tregu është përkufizimi i tregjeve me pakicë si nga ana e produktit (seksioni 3.1.1.1) ashtu edhe nga ajo gjeografike (seksioni 3.1.1.2).

3.1.1.1 Përkufizimi i tregut me pakicë të produktit

Mungesa e zëvendësueshmërisë ndërmjet shërbimeve të kategorisë familjare dhe biznesit

Tregu i shitjes me pakicë për aksesin broadband fiks në Shqipëri përbëhet nga dy segmente kryesore, segmenti i ofertave të kategorisë familjare dhe segmenti i ofertave të kategorisë së biznesit.


Karakteristikat kryesore të ofertave të shitjes me pakicë të kategorisë së përdoruesve familjarë

Ofertat për kategorinë e përdoruesve familjarë janë oferta të konektivitetit që adresojnë nevojat e përdoruesve familjarë dhe të bizneseve të vogla dhe të mesme, nevojat e të cilave janë të ngjashme me përdoruesit familjarë.

Ofertat për kategorinë e përdoruesve familjarë shpesh tregtohen nga operatorët e telekomunikacionit në formate standarde. Formate të tilla përfshijnë aksesin standalone në internet, paketat dyfishe (duke integruar aksesin në internet me shërbimet e telefonisë zanore ose TV), paketat trefishe (duke integruar aksesin në internet, telefoninë zanore dhe shërbimeve TV) dhe për operatorët që janë ofrues të shërbimeve fikse dhe celulare paketat katërfishe (duke integruar aksesin në internet, telefoninë zanore, shërbimet TV dhe shërbimet celulare).

Shërbimi fiks për kategorinë e përdoruesve familjarë mund të ofrohet me anë mjeteve të shumta (fibër optike, bakër, HFC ose teknologji të tjera me valë) dhe me shpejtësi të ndryshme nga më pak se 10 Mbps deri në mbi 1 Gbps. Këto shërbime zakonisht ofrojnë shpejtësi asimetrike shkarkimi dhe ngarkimi dhe me kohë riparimi të garantuara nga 48 orë deri në 72 orë.

Figura 29 - Volumi i akseseve broadband fiks për përdoruesit familjarë në Shqipëri (2016-2022)



Burimi: Raportet statistikore vjetore dhe tremujore të AKEP

Me kalimin e viteve, pesha e akseseve për kategorinë e përdoruesve familjarë në volumin e përgjithshëm të akseseve me pakicë ka qenë e qëndrueshme në rreth 91%. Siç vërehet në Figurën 29, ecuria e akseseve për përdoruesit familjarë është shumë e ngjashme me evolucionin e të gjithë tregut (shih Figurën 1) pasi numri i përgjithshëm i linjave u rrit me 122% që nga viti 2016 për të arritur në 535 mijë lidhje aktive deri në fund të vitit 2022. .

Karakteristikat kryesore të ofertave të shitjes me pakicë të klasës së biznesit

Në varësi të madhësisë dhe natyrës së aktiviteteve të tyre, bizneset dhe institucionet më të mëdha (bankat, spitalet, shkollat, bibliotekat, ministritë, etj.) kanë nevoja specifike për lidhje që nuk adresohen nga ofertat e kategorisë së përdoruesve familjarë. Prandaj, operatorët e telekomunikacionit kanë zhvilluar oferta që adresojnë nevojat e këtyre klientëve. Ofertat për kategorinë biznes shoqërohen shpesh nga një cilësi më e lartë shërbimi (vonesë e ulët, kohë riparimi në përgjithësi më pak se 24 orë ose 6 orë), shpejtësi simetrike të shkarkimit dhe


ngarkimit, lidhje të tepërta për të minimizuar ndikimet e një defekti, shërbime sigurie dhe shërbime monitorimi.

Përveç cilësisë më të lartë të shërbimit, ofertat për kategorinë biznes përfshijnë shërbime të tjera si linja me qira dhe lidhje të dedikuara ndërmjet vendndodhjeve të një ndërmarrjeje, rrjete private virtuale dhe shërbime të tjera ndihmëse si hostimi dhe bashkëvendosja. Shërbime të tilla nuk u propozohen përdoruesve familjarë ose bizneseve të vogla që kanë nevojë të kufizuara lidhjeje që plotësohen përmes ofertave të kategorisë se përdoruesve familjarë.

Për më tepër, shërbimet për kategorinë biznes shpesh shiten nëpërmjet kanaleve dhe proceseve të dedikuara të shitjeve (p.sh., thirrjet për tender, etj.) dhe përdorin burime specifike për shërbimet e mbështetjes dhe kujdesit ndaj klientit (p.sh., duke caktuar një menaxher të dedikuar, etj.)

Për më tepër, ndryshe nga ofertat e kategorisë se përdoruesve familjarë ku të dy çmimet janë kushte kontraktuale janë të paracaktuara nga operatori dhe ndryshohen rrallë, çmimet dhe kushtet kontraktuale të lidhura me kategorinë biznes shpesh negociohen në mënyrë dypalëshe mbi bazën e marrëveshjeve rast pas rasti dhe janë subjekt i ndryshimeve të rëndësishme.

Figura 30 - Volumi i akseseve broadband fikse të kategorisë biznes në Shqipëri (2016-2022)



Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët

Gjatë periudhës ndërmjet 2016 dhe 2021, siç tregohet në Figurën 27 më sipër, pjesa e akseseve të kategorisë së biznesit u rrit në 50 mijë aksese nga 22 mijë aksese. Gjatë gjithë periudhës, pesha e akseseve të kategorisë biznes në volumin e përgjithshëm të akseseve me pakicë ka qenë e qëndrueshme në rreth 9%.

Nga pikëpamja e ofertës, ofrimi i shërbimeve të kategorisë biznesit nga një operator që ofron vetëm për përdorues familjarë kërkon një investim në burimet njerëzore dhe logjistike, si dhe ndryshime organizative, në mënyrë që jenë në gjendje të ofrojnë oferta konkurruese për kategorinë biznes.

Për më tepër, shërbimet e kërkuara nga bizneset e mëdha janë shpesh më të avancuara teknologjikisht sesa ofertat për kategorinë e familjeve dhe kërkojnë përshtatje të teknologjive dhe infrastrukturës së përdorur për të ofruar shërbime të tilla. Për shembull, disa aplikacione kritike të bizneseve të mëdha kërkojnë kapacitete të dedikuara, shpesh me opsione

redundancy, dhe nuk mund të ofrohen mbi kapacitete të përbashkëta ose të ndërsjella, siç është rasti për shërbimet e kategorisë së përdoruesve familjarë.

Për më tepër, bizneset e mëdha shpesh kërkojnë që ofruesi i tyre të ofrojë shërbime të nivelit të sipërm (deri në shtresën e aplikacionit) së bashku me nevojat e tyre për konektivitet si një ofertë bundle. Kjo kërkon zhvillimin e një sërë njohurish brenda operatorit që shkon përtej kompetencave të kërkuara për të ofruar shërbime të kategorisë së përdoruesve familjarë.

Prandaj, për shkak të mungesës së zëvendësueshmërisë si nga pikëpamja e kërkesës ashtu edhe e ofertës, AKEP vlerëson se shërbimet e kategorisë për përdorues familjarë në nivel pakice (që përfshin shërbimet si për përdoruesit familjarë ashtu edhe për bizneset e vogla/të mesme me nevoja të ngjashme si përdoruesit familjarë) dhe shërbimet e kategorisë biznes në nivelin me pakicë nuk janë pjesë e të njëjtit treg.

Zëvendësueshmëria midis teknologjive të ndryshme me tela

Ndërsa kërkesa për aplikacione të bazuara në internet rritet; rritet nevoja për lidhje të besueshme me broadband me shpejtësi të lartë. Siç tregohet në Figurën 8, pjesa e lidhjeve me fibra në totalin e lidhjeve broadband po rritet vazhdimisht dhe me shpejtësi pasi përfaqësonte 61% në vitin 2022 krahasuar me vetëm 11% në vitin 2016. Kjo rritje është nxitur nga zhvillimi i rrjeteve të reja si dhe migrimi nga teknologji të tjera tek teknologjia me fibra.

Nga këndvështrimi i kërkesës, pavarësisht nga kapacitetet e tyre maksimale teorike inferiore, lidhjet me bazë bakri paraqesin karakteristika të ngjashme për sa i përket përdorimit si lidhjet me fibra. Prandaj, AKEP vlerëson se janë plotësuar kushtet për përcaktimin e zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës ndërmjet lidhjeve me bazë bakri dhe lidhjeve me bazë fibrash.

Modernizimi i rrjeteve kabllore koaksiale po i mundëson operatorit kryesor kabllor, Vodafone, të përdorë rrjetin e tij kabllor për të ofruar akses të shpejtë dhe ultra të shpejtë broadband për klientët e tij. Siç tregohet në Figurën 9, duke u mbështetur kryesisht në rrjetin e saj HFC, Vodafone u bë një nga ofruesit kryesorë të shërbimeve broadband në vend. Kjo tregon se, ashtu si rrjetet e bakrit, lidhjet me bazë HFC paraqesin karakteristika të ngjashme për sa i përket përdorimit si lidhje me fibra. AKEP konsideron kështu se të dyja teknologjitë janë të zëvendësueshme nga këndvështrimi i kërkesës.

Nga këndvështrimi i ofertës, të gjithë operatorët e rrjeteve në Shqipëri po investojnë në ndërtimin e rrjeteve të tyre me fibra optike. Nga njëra anë, One Albania dhe Vodafone, të cilët aktualisht mbështeten përkatësisht në rrjetet e tyre historike të bakrit dhe kablllove, po ndërtojnë rrjetet e tyre me fibra dhe po zëvendësojnë gradualisht lidhjet e tyre të bakrit dhe kablllove me fibra. Të dy operatorët kanë deklaruar synimin e tyre për të kaluar në një rrjet tërësisht me fibra në vitet e ardhshme. Nga ana tjetër, operatorë të tjerë që filluan të ndërtonin rrjetin e tyre vitet e fundit, i kanë ndërtuar rrjetet e tyre plotësisht me fibra. Disa operatorë kanë ende numër të pakët të akseseve të bazuara në kablllo bakri ose koaksiale. Megjithatë, shumë prej tyre i kanë komunikuar AKEP-it planet e tyre për të migruar këto lidhje në lidhje me fibër në muajt në vijim. Këto tendenca tregojnë se, nga ana e ofertës, ekziston një zëvendësueshmëri midis fibrës dhe kablllove bakri dhe koaksiale.

Prandaj, AKEP vlerëson se teknologjitë me tela janë të zëvendësueshme nga këndvështrimi i ofertës dhe kërkesës dhe korrespondojnë kështu në të njëjtin treg produkti.

Zëvendësueshmëria midis lidhjeve broadband bazë, të shpejta dhe ultra të shpejta

Produktet broadband që ofrohen aktualisht në tregun shqiptar përfaqësojnë një vazhdimësi në spektrin e shpejtësive të rrjetit. Operatorët që mbështeten në rrjetin e bakrit ende ofrojnë lidhje broadband bazë, përveç lidhjeve të shpejta dhe ultra të shpejta të ofruara përmes rrjetit fibër.

Pavarësisht ndryshimit të rëndësishëm në shpejtësi, lidhjet bazë mbeten të përshtatshme për shumicën e përdorimeve dhe janë të krahasueshme në performancën dhe cilësinë e shërbimit të ofruar nëpërmjet lidhjeve të shpejta. Në mënyrë të ngjashme, këto të fundit janë të krahasueshme me lidhjet ultra të shpejta. Prandaj, nga këndvështrimi i kërkesës, ekziston një zinxhir zëvendësimi midis lidhjes broadband bazë, të shpejtë dhe ultra të shpejtë që mbështet vendosjen e tyre brenda të njëjtit treg.

Megjithatë vërehet se shpejtësitë e kufizuara teorike të disponueshme përmes akseseve të bakrit mund të mos mbeten të përshtatshme për shumë përdorime në rast të një rritje të konsiderueshme të kërkesës për kapacitet në vitet e ardhshme. Kjo është e mundur për shkak të rritjes së trafikut të të dhënave dhe zhvillimit të përdorimit më intensiv të të dhënave (video-on-demand, realitet virtual, etj.) në të ardhmen. Megjithatë, ndikimi i këtij fakti është i kufizuar pasi shumë klientë DSL kanë tashmë oferta alternative të fibrave në dispozicion.

Nga pikëpamja e ofertës, pasi të gjithë operatorët po mbështeten gjithnjë e më shumë në rrjetin e fibrave, ata të gjithë mund të ofrojnë shpejtësi të krahasueshme lidhjeve për klientët e tyre. Edhe operatorët me rrjete të teknologjisë më të vjetër kanë vendosur fibra paralelisht me rrjetet e tyre ekzistuese. Kështu, shumica e ofruesve mund të ofrojnë shpejtësi më të larta të rrjetit në një kohë relativisht të shkurtër dhe pa manifestuar kosto të konsiderueshme shtesë.

Prandaj, AKEP vlerëson se lidhjet broadband bazë, të shpejta dhe ultra të shpejta janë të zëvendësueshme si nga këndvështrimi i ofertës ashtu edhe i kërkesës dhe korrespondojnë kështu me të njëjtin treg produkti.

Mungesa e zëvendësueshmërisë ndërmjet teknologjive të ndryshme me tel dhe ëireless

Aksesi në wireless broadband fiks dhe aksesi me tel bazuar në teknologji satelitore janë teknologji alternative të aksesit të disponueshme aktualisht në Shqipëri për të ofruar broadband fiks. Figura 8 tregon se pjesa e këtyre teknologjive është e vogël (rreth 1% deri në fund të vitit 2022) pasi operatorët përdorin teknologji të tilla si një opsion të fundit në rast të mungesës së alternativave të teknologjisë me tel.

Akseset ëireless broadband fiks janë shumë më të kufizuara në kapacitet sesa lidhjet e bazuara në fibra. Me zhvillimin e teknologjive me valë më efikase, shpejtësitë e disponueshme nga teknologjitë me valë si 4G dhe 5G mund të përfaqësojnë një alternativë të mundshme ndaj rrjeteve me tel, veçanërisht bakri. Megjithatë, ekziston një sërë faktorësh që e bëjnë më pak të mundshme zëvendësueshmërinë ndërmjet të dy llojeve të rrjeteve, të paktën në të ardhmen e parashikueshme.

Ndryshe nga rrjetet me tela, mund të jetë e vështirë të garantohet cilësia e shërbimit për klientët fundorë që përdorin radio frekuenca, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e tyre ndaj kushteve të motit, problemeve klimaterike dhe pengesave fizike. Përveç kësaj, përdorimi i zgjidhjeve ëireless, veçanërisht për bizneset, kërkon studime specifike fizibiliteti në rrjedhën e sipërme që çojnë në vonesa të gjata në implementimin e shërbimit.

Nga pikëpamja e ofertës, shërbimet me valë dhe ato me tela përbëjnë dy zgjidhje thelbësisht të ndryshme nga pikëpamja teknologjike pasi ato mbështeten në rrjete të dallueshme aktive dhe pasive. Kështu, një operator që ofron vetëm shërbime me valë nuk mund të kalojë në mënyrë të shpejtë në shërbime me tela pa shfaqur kosto të rëndësishme. Kjo vlen edhe për një operator që ofron vetëm shërbime me tela dhe dëshiron të ofrojë shërbime me valë.

Prandaj, AKEP vlerëson që shërbimet broadband fikse ëireless nuk janë të zëvendësueshme me shërbimet fikse me tel. Në të gjitha rastet, duke pasur parasysh peshën e ulët të lidhjeve broadband ëireless në Shqipëri dhe përdorimin e tyre si opsion i fundit, përjashtimi i këtyre shërbimeve nga objekti i përkufizimit të tregut nuk ka një ndikim të rëndësishëm.

Në kuadër të sa më sipër, nga pikëpamja e produktit, AKEP identifikon dy tregje të shitjes me pakicë:

- **Tregu i shitjes broadband me pakicë për shërbimet e kategorisë së përdoruesve familjarë** që adreson përdoruesit rezidencialë dhe bizneseve të vogla dhe të mesme me nevoja konektiviteti të krahasueshme me përdoruesit familjarë; dhe
- **Tregu i shitjes broadband me pakicë për kategorinë e biznesit** që adreson bizneset më të mëdha dhe institucionet publike që kanë nevojë për produkte specifike të konektivitetit, shpesh të shoqëruara me një cilësi të lartë shërbimesh.

Të dy tregjet përfshijnë lidhje broadband, ose të kombinuara me shërbime të tjera si TV dhe telefonia zanore ose të ofruara në baza standalone, të ofruara nëpërmjet bakrit (xDSL), fibrës optike (FTTX) ose kablos koaksiale (HFC).

Pyetje nr.6: A jeni dakort me përkufizimin e produktit për shërbimet broadband me pakicë të propozuar nga AKEP në seksionin 3.1.1.1?

3.1.1.2 Përkufizimi gjeografik i tregut me pakicë

Udhëzimet për FNT të Komisionit Evropian specifikojnë se, përpara se të ndërmerret vlerësimi i konkurrencës, tregjet duhet të përkufizohen gjeografikisht⁴⁴. Duke vlerësuar zëvendësueshmërinë dhe kushtet e tregut, përkufizimi gjeografik i tregut përfshin zona në të cilat kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëm homogjene në mënyrë që zonat që shfaqin kushte të ndryshme konkurrence të vendosen në tregje të veçanta.

Sipas praktikave rregullatore në sektorin Evropian të komunikimeve elektronike, përkufizimi gjeografik i tregjeve përcaktohet në bazë të zonës së mbuluar nga një rrjet.⁴⁵ dhe ekzistenca e instrumenteve ligjore dhe të tjera rregullatore⁴⁶. Tregjet e përcaktuara përmes analizës gjeografike mund të jenë lokale, rajonale, kombëtare ose ndërkombëtare. Në të gjitha rastet, niveli i zgjedhur i tregut gjeografik duhet të sigurojë që tregjet: "(a) janë të një madhësie të përshatshme, d.m.th. mjaft të vogla për të shmangur variacionet e rëndësishme të kushteve konkurruese brenda çdo njësie, por mjaftueshëm të mëdha për të shmangur një mikro-analizë intensive dhe të rëndë të burimeve që mund të çojë në fragmentim të tregut, (b) janë në gjendje të pasqyrojnë strukturën e rrjetit të të gjithë operatorëve përkatës dhe (c) të kenë kufij të qartë dhe të qëndrueshëm me kalimin e kohës."

⁴⁴ Burimi: "Udhëzimet e Komisionit Evropian për analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së rëndësishme të tregut sipas kuadrit rregullator të BE-së për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike", recitali 46, lidhja: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52018XC0507\(01\)](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52018XC0507(01)) (aksesi fundit më date 23.11.2023)

⁴⁵ Siç specifikohet në Udhëzimet për FNT të Komisionit Evropian, kjo zonë korrespondon në praktikë me kufijtë e zonës në të cilën një operator është i autorizuar të operojë.

⁴⁶ Të tilla si autorizimet ose licencat e kufizuara në një zonë specifike.

Për të vlerësuar nëse dhe në çfarë mase ndryshojnë kushtet e konkurrencës për shërbimet broadband në të gjithë territorin shqiptar, AKEP përdori njësinë administrative të “bashkisë” si bazë për analizën e tij. Zgjedhja e kësaj njësie, në vend të të tjerave si mbulimi i rrjetit të operatorit aktual ose topologjive të ndryshme të rrjetit, motivohet nga fakti se konkurrenca me pakicë drejtohet kryesisht nga konkurrenca ndërmjet platformave (d.m.th., shumica e operatorëve vendosin rrjetet e tyre duke përdorur infrastrukturën e tyre) dhe nuk mbështeten shumë në produktet me shumicë. Një avantazh tjetër i zgjedhjes së bashkisë si njësi bazë për analizën është disponueshmëria e të dhënave socio-ekonomike dhe specifike sektoriale, të cilat janë të nevojshme për të vlerësuar kushtet e konkurrencës në nivel nënkombëtar.

I ndërgjegjshëm për heterogjenitetin e mundshëm në kushtet e konkurrencës brenda çdo bashkie, AKEP ka bërë një dallim të mëtejshëm midis zonave urbane dhe rurale. **Një “zonë lokale” përkufizohet kështu si një zonë rurale ose urbane e një bashkie administrative**⁴⁷. Megjithatë, disponueshmëria e të dhënave për zonat urbane dhe rurale është e kufizuar në kohë dhe në shtrirje pasi është e disponueshme vetëm për disa të dhëna specifike sektoriale në 2021 dhe 2022. Analiza e mëposhtme do të kryhet duke përdorur të dhënat më të hollësishme të disponueshme.

Në vlerësimin e homogjenitetit të kushteve të konkurrencës, në përputhje me udhëzimet e BEREC⁴⁸, do të merren parasysh kriteret e mëposhtme:

- Barrierat për hyrjen në treg: qëllimi është të përcaktohet nëse kërkesa rritet, hyrjesit e rinj do ta vlerësojnë si fitimprurëse hyrjen në treg për të përfituar nga ekonomitë më të mëdha të shkallës.
- Presioni konkurrues ndaj operatorit më të madh: kjo analizë merr parasysh edhe numrin dhe madhësinë e konkurrentëve dhe prezencën e tyre gjeografike në të gjithë territorin.
- Pjesët e tregut të operatorëve brenda çdo zone dhe ecuria e tyre në dy vitet e fundit.
- Dallimet e çmimeve midis zonave dhe nëse operatorët që janë të pranishëm në zona të shumta aplikojnë strategji të ndryshme çmimi në varësi të zonës.
- Aspekte të tjera që mund të rrjedhin nga dallimet përkatëse konkurruese midis zonave gjeografike (p.sh., strategjitë e marketingut dhe funksionalitetet e ofertave).

Nuk ka evidenca për barrierat strukturore për hyrjen në zonat lokale pasi numri i konkurrentëve rritet në shumicën e zonave

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga AKEP nga operatorët në vitet 2021 dhe 2022, AKEP vëren se numri i konkurrentëve të pranishëm në çdo zonë lokale është përgjithësisht në rritje

⁴⁷ Në analizë janë përfshirë 61 bashki administrative. Brenda çdo komune bëhet dallimi ndërmjet zonave rurale dhe urbane. Prandaj, gjithsej 122 zona lokale ishin në dispozicion për analizë. Në vitin 2022, akses zero është raportuar në zonat e mëposhtme: Skrapar (Rural), Dropbull (Urban), Dropbull (Rural) dhe Libohovë (Rural). Prandaj, (122-4)118 zona lokale janë përfshirë në analizë. Në vitin 2021, gjithsej 117 zona lokale janë përfshirë në analizë pasi ekzistojnë 5 zona lokale pa akses të raportuar: Skrapar (Rural), Devoll (Rural), Dropbull (Urban), Libohovë (Rural) dhe Këlcyrë (Rural). Mungesa e të dhënave për këto zona vendore mund të jetë për shkak të cilësisë së të dhënave të mbledhura nga AKEP nga operatorët.

⁴⁸ Burimi: BEREC “Pozicioni i përbashkët i BEREC për aspektet gjeografike të analizës së tregut (përkufizimi dhe mjetet juridike)”, lidhje: [*Pozicioni i përbashkët BEREC mbi aspektet gjeografike të analizës së tregut \(përkufizimi dhe mjetet juridike\) \(europa.eu\)](#) (aksesimi i fundit më 24/11/2023)

pasi numri i zonave lokale me vetëm një ofrues është ulur dhe numri i zonave lokale me më shumë se tre ofrues është rritur.

Tabela 1 – Përmbledhje e përqindjes së zonave lokale në varësi të numrit të ofruesve të shërbimeve

	1 ofrues	2 ofrues	3 ofrues	Më shumë se 3 ofrues
2021	18%	17%	19%	47%
2022	11%	19%	14%	56%

Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët

Në vitin 2022, vetëm 13 zona lokale (11%) kishin vetëm një ofrues shërbimi me broadband krahasuar me 22 (18%) në 2021. Midis këtyre 13 zonave, One Albania është ofruesi i vetëm në vetëm 4 zona lokale, ndërsa 9 zonat e mbetura lokale kanë ofrues lokalë me prezencë në një numër shumë të kufizuar zonash (vetëm dy deri në katër zona lokale).

Për më tepër, midis 2021 dhe 2022, numri i zonave lokale të mbuluara nga më shumë se tre ofrues shërbimesh u rrit nga 55 (47%) në 66 (56%).

Në zonat lokale me ofrues të shumëfishtë shërbimesh, presioni i konkurrencës është përgjithësisht i lartë. Mesatarisht, në të gjitha zonat lokale me të paktën një lidhje broadband, ka pesë ofrues shërbimesh me pakicë në çdo zonë lokale. Kjo mesatare është vetëm pak më e lartë në zonat urbane (5,5) sesa në zonat rurale (4,5). Megjithatë, ekzistojnë dallime të rëndësishme ndërmjet zonave lokale. Për shembull, në vitin 2022, 33 operatorë ofruan shërbime broadband në zonat urbane të Tiranës, që është dukshëm më e lartë se mesatarja kombëtare.

Për shkak të ekonomive të kufizuara të shkallës, është e zakonshme të pritët që barrierat ekonomike për hyrje të jenë më të larta në zonat rurale në krahasim me zonat urbane. Megjithatë, siç u shpjegua më lart, ka vetëm disa zona lokale (me pak të populluara) me vetëm një ofrues të broadband fiks. Gjithashtu, AKEP vëren se numri mesatar i operatorëve në një zonë lokale është i lartë (5 operatorë) dhe 70% e zonave lokale kanë tre ose më shumë ofrues.

Në zonat lokale ku konkurrenca është më pak e zhvilluar, madhësia e tregut është shpesh shumë e vogël. Në zonat lokale me vetëm një ofrues shërbimi broadband, numri i përgjithshëm i lidhjeve varion nga 45 në 644 lidhje. Megjithatë, me përparimin e penetrimit të shërbimeve broadband fiks, konkurrenca në fusha të tilla mund të zhvillohet në vitet e ardhshme me rritjen e mundshme të kërkesës. Midis 2021 dhe 2022, numri i përgjithshëm i aksesëve u rrit në 63%. Ndërsa zhvillimi i shërbimeve fikse broadband në Shqipëri përparon (shih seksionin 1.1), ky trend pritët të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.

Në shumicën e zonave lokale, operatori kryesor është nën trysni të besueshme në rritje të konkurrencës nga operatorët e tjerë.

Me rritjen e numrit të konkurrentëve, rritet edhe presioni mbi operatorët leader lokal. Në të vërtetë, midis 2021 dhe 2022, numri i operatorëve është rritur në 2022 në 45% të zonave lokale.

Për të vlerësuar nëse ekziston një presion i besueshëm konkurrues mbi operatorët leader lokal, është e rëndësishme të analizohet madhësia dhe mbulimi gjeografik i operatorëve që sfidojnë operatorin leader lokal. Në 56% të zonave lokale, ekziston të paktën një operator

sfidues me një mbulim më të gjerë gjeografik (në numër zonash lokale) se operatori leader lokal.

Siç tregohet në Figurën 20, vetëm gjashtë operatorë janë të pranishëm në dhjetë ose më shumë bashki (këta gjashtë operatorë do të referohen më tutje si "operatorët kryesorë"). Pavarësisht nga mbulimi i tyre relativisht i gjerë gjeografik, këta operatorë, duke përfshirë edhe operatorin incumbent, janë operatorët leader në treg në një numër të kufizuar zonash lokale. Kjo do të thotë se shpesh ka një operator të madh në një pozicion sfidues që ushtron presion mbi operatorin leader lokal.

Për më tepër, në zonat ku një nga operatorët kryesorë është një operator leader lokal, ata zakonisht janë nën presion konkurrues nga operatorë të tjerë me një mbulim të krahasueshëm gjeografik. Deri në fund të vitit 2022, vetëm tre operatorë në të gjithë tregun ishin leader në pesë zona lokale ose më shumë.

Tabela 2 – Operatorët si lider tregu në pesë zona lokale ose më shumë që nga viti 2022

Operatori	Numri i zonave lokale urbane si lider	Përfshin mbi 50%	Përfshin mbi 80%	Numri i zonave lokale rurale si lider	Përfshin mbi 50%	Përfshin mbi 80%
One Albania	26	23	10	7	5	4
Vodafone	9	3	0	0	0	0
ASC	5	1	1	0	0	0

Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët

Me një prani në gjithsej 93 (79%) të bashkive në vitin 2022, One Albania është operatori me mbulimin më të gjerë gjeografik. Megjithatë, One Albania është lider në vetëm 33 në zonat lokale (28%), ndër të cilat 26 janë urbane dhe 7 janë rurale. Në ato zona urbane, One Albania kishte më shumë se 50% të pjesëve të tregut në 23 zona urbane lokale dhe mbi 80% të pjesëve të tregut në 10 zona lokale urbane. Në zonat rurale, One Albania kishte më shumë se 50% të pjesës së tregut në pesë zona lokale, ku në katër prej të cilave pjesa e tregut të operatorit incumbent tejkalonte 80%.

Në vitin 2022, Vodafone ishte operatori lider në 9 zona urbane lokale, nga të cilat pjesa e tregut të operatorit tejkaloi 50% në tre zona lokale. Edhe pse është lider në pesë zona lokale, ASC kishte më shumë se 50% të pjesës së tregut, është vetëm një zonë lokale, një zonë në të cilën pjesa e tregut të operatorit tejkaloi 80%.

Prandaj, operatori më i madh në secilën prej 71 zonave të mbetura lokale (60%) janë operatorë leader në një numër më të kufizuar zonash lokale (midis 1 dhe 4).

Fakti që operatorët me një mbulim të gjerë gjeografik janë liderë në një numër të kufizuar zonash lokale tregon mungesën e barrierave strukturore për hyrjen në treg. Në të vërtetë, pavarësisht pabarazive relativisht të rëndësishme në mbulimin gjeografik midis ofruesve të broadband në Shqipëri, operatorët me mbulimin më të gjerë janë shpesh sfiduesit në zonat lokale, gjë që tregon se operatorët sfidues lokalë ushtrojnë një presion të besueshëm konkurrues mbi operatorët leader lokal.

Ndërsa konkurrenca rritet, operatorët lider lokalë po humbasin pjesë të tregut veçanërisht në zonat ku ata zotëronin më shumë se 50% të pjesës së tregut.

Për të vlerësuar më tej besueshmërinë e presionit konkurrues të ushtruar nga operatorët është e rëndësishme të analizohet ecuria në kohë e pjesës së tregut të operatorit lider lokal. Ndërmjet viteve 2021 dhe 2022, AKEP vëren se pjesa e tregut të operatorëve leader lokal u ul në 56% të zonave lokale (59% të zonave urbane dhe 53% të zonave rurale). Në zonat ku operatori lider lokal mbante 50% ose më shumë të pjesës së tregut në vitin 2021, pjesa e tregut të liderit u ul në 72% të zonave lokale (75% e zonave urbane dhe 69% e zonave rurale).

Pavarësisht disa ndryshimeve në çmime në zonat lokale, strategjia e çmimeve të operatorëve nuk ndryshon në mënyrë të ndjeshme bazuar në kriteret gjeografike.

Për më tepër, analiza e çmimeve të shërbimeve të broadband fiks në të gjithë zonat lokale ofron një panoramë të dobishme për të vlerësuar nëse kushtet e konkurrencës janë homogjene.

Të dhënat e mbledhura nga faqjet e internetit të operatorëve në përgatitjen e këtij vendimi çuan në përfundimin se ekzistojnë disa dallime në çmime ndërmjet ofruesve lokal. Për shembull, për lidhjet bazike broadband (d.m.th., më pak se 30 Mbps), çmimi i ofruar nga operatorët kryesorë ishte mesatarisht rreth 1 200 LEK, ndërsa operatorët të tjerë leader lokalë ofruan çmime që variojnë nga 1 200 LEK deri në 2 000 LEK, me shumicën e operatorëve duke ofruar nga 1 200 LEK dhe 1 600 LEK. Në mënyrë të ngjashme, për lidhjet më të ulëta broadband ultra të shpejtë (d.m.th., 100 Mbps), çmimi i ofruar nga operatorët kryesorë varionte nga 1 300 LEK dhe 1 700 LEK, ndërsa operatorët e tjerë leader lokal ofruan çmime që variojnë nga 1 500 LEK deri në 5 000 LEK. Sidoqoftë, këto rezultate duhet të interpretohen me kujdes. Në të vërtetë, niveli i shpejtësisë së shkarkimit mund të ndryshojë nga një operator në tjetrin duke ndikuar në krahasueshmërinë midis çmimeve (ky është rasti për lidhjet bazike broadband), këto të dhëna bazohen në informacionin publik që mund të mos jetë i përditësuar dhe teknologjia bazë mbi të cilin ofrohet shërbimi mund të mos jetë gjithmonë i njëjtë.

Për të vlerësuar nëse çmimet e shitjes me pakicë janë të krahasueshme midis zonave, AKEP mori parasysh i) mbulimin gjeografik të operatorëve që shpesh konkurrojnë me njëri-tjetrin; ii) niveli i çmimeve të këtyre operatorëve dhe iii) nëse këta operatorë aplikojnë çmime të ndryshme në varësi të zonës gjeografike.

Së pari, në vitin 2022, rrjeti i operatorëve kryesorë mbulonte 95 (81%) zona lokale, ndër të cilat 93 mbulohen nga operatori incumbent. Këta operatorë ushtrojnë presion konkurrues në shumicën e zonave në të cilat ata janë të pranishëm pasi pjesa e tyre e kombinuar e tregut kalon 20% në 87 (74%) zona lokale. Së dyti, Figura 33 tregon se çmimet e ofruara nga disa prej dy operatorëve kryesorë që kanë mbulimin më të madh gjeografik dhe pjesët më të larta të tregut janë, në një masë të madhe, të krahasueshme në shpejtësi të afërta. Së treti, operatorët me një mbulim të gjerë gjeografik priren të aplikojnë të njëjtat çmime me pakicë për të gjithë klientët e tyre (veçanërisht klientët familjarë) pavarësisht nga zona në të cilën ata ndodhen⁴⁹.

Prandaj, ka evidenca që tregojnë se kushtet e çmimeve janë homogjene në një pjesë të madhe të zonave lokale (81%) në të cilat është të paktën një nga operatorët kryesorë në ofrimin e shërbimeve, veçanërisht në zonat ku një prani e tillë ushtron një presion konkurrues në vend. ofruesit.

Në përgjithësi, ka elementë që mbështesin faktin se mundësia e devijimit nga çmimet e operatorëve kryesorë është, në praktikë, e kufizuar. Së pari, çmimet zakonisht përcaktohen në

⁴⁹ Disa operatore mund të axhustojnë çmimet e tyre lokalisht duke aplikuar ulje në çmime si oferta të kufizuara. Megjithatë, këto axhustime janë bere në menyre rastesore dhe janë të vlefshme vetem për një periudhë të kufizuar.


zonat ku konkurrenca është më e zhvilluar. Kështu, sa herë që një operator me një mbulim të gjerë kombëtar është i pranishëm në një zonë lokale, operatorët lokalë me mbulim të kufizuar gjeografik marrin parasysh çmimet e përcaktuara në nivel kombëtar të konkurrentëve të tyre kur përcaktojnë çmimet e tyre në mënyrë që të mbeten konkurrues. Së dyti, në zonat lokale ku të gjithë konkurrentët janë ofrues lokalë (d.m.th., asnjë nga operatorët kryesorë nuk është i pranishëm), këta të fundit konsiderojnë gjithashtu çmimet e përcaktuara në nivel kombëtar pasi çdo rritje e rëndësishme e çmimeve të tyre lokale do të tërheqë hyrës të rinj dhe do të rrezikojë pozicionin e tyre në treg. Së treti, operatorët me mbulim të gjerë gjeografik mungojnë kryesisht në zonat me dendësi të ulët të popullsisë dhe fuqi blerëse më të ulët. Në zona të tilla, aftësia e operatorëve lokalë për të devijuar nga çmimet e përcaktuara në nivel kombëtar është e kufizuar nga fuqia e kufizuar blerëse e popullsisë lokale. Së katërti, ndërsa shërbimi broadband ëireless u konsiderua i pazëvendësueshëm me shërbiminbroadband fiks (seksioni3.1.1.1), kryesisht për mungesën e zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës, ofertat celulare dhe teknologjitë e tjera ëireless ushtrojnë njëfarë presioni konkurrues mbi ofruesit lokalë veçanërisht në zonat rurale, duke kufizuar kështu aftësinë e tyre për të devijuar nga çmimet e përcaktuara në nivel kombëtar. Së fundi, çdo devijim nga çmimet kombëtare mund të lidhet me koston bazë të shërbimeve (për shembull në rastin e lidhjeve satelitore) dhe nuk janë produkt i një sjelljeje abuzive nga operatorët lokalë.

Pavarësisht disa ndryshimeve të vërejtura në çmime në zonat lokale, në varësi të faktit nëse një nga operatorët kryesorë është i pranishëm apo jo, AKEP beson se strategjia e çmimeve të operatorëve nuk ndryshon në mënyrë të ndjeshme në të gjithë territorin shqiptar.

Strategjitë tregtare të operatorëve dhe karakteristikat teknike të shërbimeve të tyre nuk ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme në varësi të zonës lokale.

Përveç sa më sipër, elementë të tjerë vënë në dukje mungesën e heterogjenitetit në kushtet e konkurrencës në zonat lokale në Shqipëri. Për shembull, strategjia e marketingut dhe e shitjeve të operatorëve me një mbulim të gjerë gjeografik nuk duket të ndryshojë në varësi të vendndodhjes. Në të vërtetë, përveç çmimeve të përcaktuara në nivel kombëtar, operatorët zakonisht ofrojnë të njëjtën cilësi shërbimi dhe përdorin të njëjtat burime për të tregtuar ofertat e tyre në të gjitha zonat lokale ku ata janë të pranishëm.

Figura 31 – Shpejtësi të ndryshme shkarkimi të ofruara nga operatorët kryesorë dhe leader lokal.



Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët

Faktorë të tjerë të rëndësishëm për t'u marrë parasysh janë karakteristikat teknike të shërbimit. Një studim i shërbimeve të ofruara aktualisht nga shumica e operatorëve në Shqipëri tregon se operatorët lider lokal me një mbulim të kufizuar gjeografik ofrojnë përgjithësisht shpejtësi broadband të krahasueshme me ato të ofruara nga operatorët kryesorë. Figura 32 tregon se lidhjet broadband bazike mbeten kategoritë kryesore si për operatorët kryesorë kombëtarë (të kombinuar) ashtu edhe për operatorët e tjerë lider lokalë (të kombinuar), dhe përqindja e lidhjeve broadband është e krahasueshme. Dallimi kryesor megjithatë është se operatorët kryesorë kombëtarë ofrojnë më shumë lidhje broadband ultra të shpejtë se të tjerët.

Tendenca e përgjithshme drejt tregjeve lokale më konkurruese dhe strategjive komerciale dhe homogjene të çmimeve mbështet një përkufizim kombëtar të tregjeve broadband me pakicë.

Në mënyrë të përmbledhur, AKEP vëren disa dallime midis zonave lokale në lidhje me numrin e operatorëve, madhësinë e tregut të adresueshëm, numrin e lidhjeve dhe dallimet socio-ekonomike në popullsinë lokale. Megjithatë, pavarësisht këtyre dallimeve dhe duke pasur parasysh mënyrën se si është zhvilluar konkurrenca në zona të ndryshme dhe tendencat e zgjerimit të rrjetit të shumë ofruesve të shërbimeve broadband, AKEP nuk identifikoi barrierat strukturore për hyrjen e konkurrentëve të rinj në zonat lokale. Për më tepër, prania e presionit konkurrues mbi operatorët leader lokal, veçanërisht nga operatorët me një mbulim më të gjerë gjeografik, dhe ecuria e pjesëve të tregut të liderëve lokal midis 2021 dhe 2022 sinjalizojnë një zhvillim të konkurrencës në të gjithë territorin shqiptar. Për më tepër, mungesa e dallimeve në strategjitë e çmimeve dhe komerciale, veçanërisht nga operatorët me një mbulim të gjerë gjeografik, në të gjithë zonat lokale tregon edhe kushte homogjene të konkurrencës. Kjo konfirmohet nga krahasueshmëria e funksionaliteteve teknike të shërbimeve broadband në zona të ndryshme lokale.

Nisur nga ecuria e vazhdueshme e konkurrencës në shumicën e zonave lokale dhe homogjeniteti i kushteve të konkurrencës në të gjithë territorin shqiptar, AKEP nuk beson se një përkufizim gjeografik nën-kombëtar është i përshtatshëm pasi një përkufizim i tillë nuk do të përmbushte kushtin për të pasur kufij të qartë dhe të qëndrueshëm në kohë. Për më tepër, AKEP beson se një përkufizim nënkombëtar i tregut do të kërkonte analizë më të thellë dhe mund të çonte në një fragmentim joefikas të tregut.

Prandaj, AKEP propozon ruajtjen e përcaktimit të tregut të shitjes me pakicë si kombëtar, si për shërbimet broadband fiks për familjet ashtu edhe për biznes.. Ky përkufizim kombëtar është veçanërisht i rëndësishëm për tregun e biznesit për shkak të natyrës së kërkesës. Në të vërtetë, bizneset shpesh kërkojnë shërbime për shumë vende që mbështeten në një disponueshmëri të gjerë gjeografike të shërbimeve⁵⁰.

⁵⁰ Nje analize e ngjashme eshte kryer nga Autoriteti Rregullator ne Rumani ne vitin 2020. Kjo analize coi ne nje konkluzione te ngjashem me ate te propozuar nga AKEP ne kete dokument. Per me teper detaje, shih **seksionin** Error! Reference source not found. **te Aneksit**

Pyetje nr.7: A jeni dakort me përkufizimin gjeografik të shërbimeve broadband me pakicë të propozuar nga AKEP në seksionin 3.1.1.2?

3.1.2 Përkufizimi i tregut me shumicë

3.1.2.1 Përkufizimi i tregut të produktit me shumicë

Siç përcaktohet nga Komisioni Evropian në rekomandimet e tij për tregjet përkatëse të ndjeshme për rregullim ex-ante⁵¹, për të ofruar shërbime broadband fikse, kërkohet një kanal i përshtatshëm komunikimi që të jetë në gjendje të kalojë të dhëna në të dy drejtimet dhe me tarifa të përshtatshme për shërbimin e kërkuar. Në praktikë, operatorët kanë zgjedhjen midis ndërtimit dhe ofrimit të shërbimeve të tyre përmes rrjetit të tyre dhe/ose marrjen e aksesit në një infrastrukturë tashmë ekzistuese nga operatorë të tjerë nëpërmjet një oferte me shumicë.

Nivele të ndryshme rrjeti për produktet e aksesit me shumicë dhe tregjet e përcaktuara aktualisht

Aksesi në rrjet mund të jepet në disa nivele rrjeti. Historikisht në Evropë, hyrësit e rinj prireshin të mbështeteshin në rrjetin ekzistues të më të përhapur të operatorit incumbent duke kërkuar akses në nivel më të lartë rrjeti (për shembull, nëpërmjet një aksesit në nivel qendror/bitstream) në mënyrë që t'i shërbenin një baze të gjerë klientësh të shpërndarë gjeografikisht. Ndërsa operatori i ri ndërton bazën e tij të klientëve, ai kërkon akses në një nivel më të ulët të rrjetit (nëpërmjet një aksesit lokal) në mënyrë që të ketë më shumë kontroll mbi cilësinë e shërbimit dhe kostot e shërbimeve të tij.

Aksesi me shumicë broadband mund të jepet në nivel qendror ose lokal. Në analizën e fundit të tregut dhe në përputhje me Rekomandimet e Komisionit Evropian të vitit 2014, AKEP përcaktoi në vitin 2016 tre tregje me shumicë:

- **Tregu me shumicë i aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA);**
- **Tregu me shumicë i aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA); dhe**
- **Tregu me shumicë i aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA).**

Analiza e mëposhtme do të vlerësojë nëse rishikimi i përkufizimit të produktit të këtyre tregjeve është i justifikuar në kuadrin e zhvillimeve më të fundit teknologjike në sektorin e telekomunikacionit.

Për mungesën e nevojës për rivlerësim të karakteristikave të produktit dhe kufijve të tregjeve të aksesit me shumicë

Mbi rëndësinë e mbajtjes së aksesëve fizike dhe virtuale brenda të njëjtit treg

Në analizën e tregut të vitit 2016, AKEP analizoi rëndësinë e dallimit ndërmjet produkteve të aksesit fizik dhe virtual dhe arriti në përfundimin se një dallim i tillë nuk është më i rëndësishëm,

⁵¹ Commission's staff working document, Explanatory Note Accompanying the document Commission recommendation on relevant product and service markets within the electronic communications sector susceptible to ex ante regulation in accordance with Directive (EU) 2018/1972 of the European Parliament and of the Council of 11 December 2018 establishing the European Electronic Communications Code, section 4.1.2, page 40.

duke i vendosur kështu të dy llojet e aksesëve brenda të njëjtit treg. AKEP gjykon se konkluzione të tilla mbeten të rëndësishme për ciklin e ardhshëm rregullator.

Në analizën e tij të tendencave kryesore të zhvillimeve teknologjike brenda sektorit Evropian të komunikimeve elektronike, Komisioni Evropian vuri në dukje se tendencat e vëzhguara si ulja e përdorimit të aksesit fizik dhe përgjithësimi i aksesit me shumicë bazuar në Aksesin Lokal Virtual (VULA) ka të ngjarë të vazhdojnë në të ardhmen e parashikueshme. Komisioni Evropian pret që aksesit virtual të bëhet produkti kryesor i aksesit me shumicë dhe aksesit fizik të zvogëlohet në rëndësi.

Për sa kohë që aksesit virtual ofron aftësi të ngjashme me aksesin fizik, të dy llojet e aksesit do të përfshihen në të njëjtin treg. Kjo qasje është në përputhje me analizën e shumicës së autoriteteve rregullatore kombëtare në Evropë, të cilët zgjedhën të përfshijnë aksesin fizik dhe virtual brenda të njëjtit treg aksesit lokal me shumicë.⁵²

Në përcaktimin e tregjeve të aksesit me shumicë, AKEP u mbështet në kriteret e mëposhtme:

- vendndodhjen aktuale të pikës së dorëzimit: kryesisht duke bërë dallimin midis aksesit të ofruar në nivel lokal nga aksesit i ofruar në një nivel më të lartë rrjeti;
- topologjinë dhe karakteristikat kryesore të transmetimit core të produkteve me shumicë, veçanërisht në lidhje me contention në rrjet: dhe
- shkalla e fleksibilitetit që kontrolli i rrjetit u lë kërkuarve të aksesit për të diferencuar ofertat e tyre me pakicë.

Mbi rëndësinë e mbajtjes së tregjeve të ndara të produkteve për produktet me akses lokal dhe qendror

Pyetja nëse tregu duhet të përcaktohet ngushtësisht (lokal) apo më gjerësisht (lokal dhe qendror) duhet të bazohet në një sërë faktorësh të tillë si shkalla e virtualizimit të produkteve të aksesit me shumicë, specifikimet teknike të aksesit lokal me shumicë dhe qendror me shumicë, modelet e vëzhguara të zëvendësimit të kërkesës me shumicë dhe pakicë. Për të gjithë faktorët e përmendur më sipër, veçanërisht ata që lidhen me specifikimet teknike të produkteve me shumicë, AKEP nuk vëren ndonjë ndryshim domethënës që nga analiza e mëparshme e tregut që justifikon ndryshimin e konkluzionit se produktet e aksesit me shumicë në nivel lokal dhe qendror mbeten plotësues dhe jo zëvendësues.

Në të vërtetë, duke qenë se produktet e rregulluara me shumicë që ofrohen aktualisht në treg bazohen në rrjetin e bakrit të sipërmarrësit One Albania, niveli i rrjetit në të cilin transferohet trafiku mbetet një faktor diferencues midis produkteve të aksesit me shumicë në nivel lokal dhe qendror. Në të vërtetë, shërbimet e aksesit me shumicë në nivel qendror me shumicë i lejojnë operatorët t'i shërbejnë një zone më të gjerë gjeografike dhe të krijojnë një prani në treg, pa shkaktuar kosto tepër të larta.

Për më tepër, produktet e aksesit me shumicë në nivel qendror të disponueshme aktualisht në treg nuk i ofrojnë kërkuarve të aksesit kapacitete të pakontestueshme ekuivalente me ato të marra nëpërmjet produkteve të aksesit lokal.

⁵² Dokumenti i punës së stafit të Komisionit, Shënim shpjegues që shoqëron dokumentin Rekomandimi i Komisionit për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike të ndjeshme ndaj rregullimit ex ante në përputhje me Direktivën (BE) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2018 duke vendosur Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike, seksioni 4.1.2, faqe 44.

Për më tepër, për të konsideruar si zëvendësues produktet e aksesit lokal dhe qendror, kërkuesi i aksesit duhet të ketë kontroll të mjaftueshëm mbi rrjetin e transmetimit, proceset operacionale dhe të biznesit, si dhe shërbimet dhe sistemet ndihmëse, në mënyrë që të fitojë kontroll të mjaftueshëm mbi cilësinë e shërbimi i ofruar për përdoruesit fundorë. Me zhvillimin e rrjeteve të gjeneratës së re, veçanërisht përmes rrjeteve fibër nga operatorë alternativë, po rritet numri i operatorëve që investojnë në kapacitete të tilla. Megjithatë, qëndrueshmëria ekonomike e investimeve të tilla mbetet e kufizuar në zona të caktuara gjeografike. Si i tillë, kontrolli i kërkuesit të aksesit mbi rrjetin e transmetimit, proceset operacionale dhe të biznesit, si dhe shërbimet dhe sistemet ndihmëse mbeten të pjesshme.

Për arsyet e detajuara më sipër, AKEP propozon që ruajtja e dallimit ndërmjet produkteve të aksesit me shumicë lokale dhe qendror është e rëndësishme për ciklin e ardhshëm rregullator.

Mbi rëndësinë e mbajtjes së tregjeve të veçanta të produkteve për tregun e përgjithshëm dhe produktet me akses me cilësi të lartë

Me zhvillimin e rrjetit me kapacitet shumë të lartë në përgjithësi, produktet e ofruara për kategorinë e përdoruesve familjarë po bëhen gjithnjë e më efikase, veçanërisht për sa i përket kapacitetit të disponueshëm. Ky përmirësim çoi në shfaqjen e një tendence brenda Bashkimit Evropian të klientëve biznes që mbështeten në infrastrukturën e broadband të tregut të përgjithshëm⁵³. Në Shqipëri, siç shpjegohet në seksionin 3.1.1.1, disa biznese të vogla dhe të mesme përdorin shërbime broadband për përdorues familjarë për nevojat e tyre të lidhjes.

Megjithatë, bashkëekzistenca e shërbimeve të kategorisë biznes dhe atyre të familjarë ka të ngjarë të vazhdojë në të ardhmen pasi këto të fundit mbeten të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e bizneseve dhe institucioneve të mëdha për besueshmëri më të lartë, redundancy më të ulët dhe cilësi më të lartë shërbimi. Për më tepër, shërbimet e kategorisë përdorues familjarë mbeten të papërshtatshme për t'i shërbyer disa nevojave specifike, si p.sh. vendosja e lidhjeve ndërmjet vendndodhjeve të shpërndara gjeografikisht të klientëve biznes kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për më tepër, në një nivel rrjeti, akseset e ofruara për bizneset dhe institucionet e mëdha shpesh mbështeten në një arkitekturë rrjeti të ndryshme (p.sh., Point-to-Point) sesa shërbimet e kategorisë përdorues familjarë (p.sh., Point-to-Multi-Points), duke kufizuar kështu zëvendësueshmërinë nga ana e ofertës dhe nga ana e kërkesës ndërmjet shërbimeve të kategorisë përdorues familjarë dhe biznes.

Për arsyet e detajuara më sipër, AKEP mendon se ruajtja e dallimit midis produkteve të aksesit të shërbimeve të kategorisë përdorues familjarë dhe kategorisë biznes është e rëndësishme për ciklin e ardhshëm rregullator.

Për sa më sipër, nga pikëpamja e produktit AKEP propozon ruajtjen e të njëjtave tregje me shumicë siç përcaktohen në vendimin e analizës së tregut të AKEP 2016.

3.1.2.2 Përkufizimi i tregut gjeografik me shumicë

Pavarësisht ekzistencës së ndryshimeve të evidentuara të konkurrencës në zona të ndryshme gjeografike, siç tregohet në seksion 3.1.1.2 AKEP ruan një përkufizim kombëtar të të tre

⁵³ Dokumenti i punës së stafit të Komisionit, Shënim shpjegues që shoqëron dokumentin Rekomandimi i Komisionit për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike të ndjeshme ndaj rregullimit ex ante në përputhje me Direktivën (BE) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2018 duke vendosur Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike, seksioni 4.1.2, faqe 44.

tregjeve të aksesit me shumicë të identifikuar. Kjo zgjedhje është motivuar nga mbulimi i gjerë i rrjetit të operatorit incumbent, i cili mbulon në vitin 2022, sipas raportimit të operatorit në AKEP, 93 nga 122 zonat lokale të përcaktuara në seksion.3.1.1.2.

Pyetje nr.8: A jeni dakort me përkufizimin gjeografik dhe të produktit për shërbimet e aksesit me shumicë në rrjet të propozuar nga AKEP në seksionin 3.1.2?

3.2 Vlerësimi i konkurrencës në tregjet përkatëse të shitjes me pakicë dhe shumicë

3.2.1 Vlerësimi i konkurrencës në tregjet me pakicë


Duke marrë parasysh analizën e propozuar të AKEP-it për përkufizimin përkatës të tregjeve me pakicë nga të dyja perspektivat e produktit (3.1.1.1) dhe ajo gjeografike (3.1.1.2), AKEP identifikon dy tregje të shitjes me pakicë:

- Një treg kombëtar me pakicë për shërbimet broadband për familje; dhe
- Një treg kombëtar me pakicë për shërbimet broadband biznes.

Seksionet e mëposhtme synojnë të vlerësojnë konkurrencën në këto dy tregje.

3.2.1.1 Konkurrenca në tregun e shitjes me pakicë për shërbimet broadband për familjet

Figura 32 – Pjesët e tregut (në volum) në tregun me pakicë për shërbimet broadband për familje (2017-2022)



Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët

Figura 33 tregon evolucionin e pjesëve të tregut të operatorëve midis 2017 dhe 2022 për shërbimet rezidenciale të aksesit në internet. AKEP vëren një tendencë të ngjashme me Figurën 19 me një përgjysmim të pjesës së tregut të One Albania, duke arritur në 20% në 2022

nga 40% në 2017, ngritjen e Vodafone si operatori me më të madhin në treg dhe rritjen e pjesës së tregut të operatorëve më të vegjël.


Duke marrë parasysh ecurinë e konkurrencës në treg gjatë 6 viteve të fundit, AKEP e konsideron tregun me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë familje si mjaft konkurrues.

3.2.1.2 Konkurrencë në tregun e shitjes me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë biznes

Brenda tregut të shitjes me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë së biznesit, AKEP bën dallimin midis dy produkteve kryesore, aksesit në internet dhe shërbimeve të linjave/kapacitetit me qira.

Shërbimet e aksesit në internet të përfshira në këtë treg u shiten klientëve jo familjare, duke përfshirë bizneset private dhe institucionet publike. Ato përfshijnë kontratat e lidhura nga operatorët dhe klientët në kuadër të një marrëveshjeje biznesi.

Figura 33 – Pjesët e tregut (në volum) në tregun me pakicë për shërbimet e aksesit në internet të kategorisë biznes (2017-2022)



Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët


Për shërbimet e aksesit në internet të nivelit të biznesit, bazuar në të dhënat e mbledhura nga AKEP nga operatorët mes viteve 2017 dhe 2022, operatori incumbent humbi 20 pikë përqindje të pjesës së tregut, pasi mbante 16% në 2022. Përkundrazi, konkurrentët e tjerë, si Vodafone dhe Abissnet fituan pjesën e tregut pasi ata u bënë operatorët kryesorë me përkatësisht 26% dhe 20% të pjesëve të tregut në vitin 2022.

Duke marrë parasysh ecurinë e konkurrencës në treg gjatë periudhës 2017-2022, AKEP e konsideron tregun me pakicë të shërbimeve të internetit të kategorisë biznes të jetë mjaft konkurrues.

Linjat me qira/shërbimet e kapacitetit përfshijnë kapacitetin e rezervuar nga një operator në rrjetin e tij për të lidhur dy ose më shumë vendndodhje nëpërmjet një lidhjeje fizike ose virtuale,

e cila siguron kapacitet të garantuar ose të dedikuar ndërmjet dy pikave në çdo kohë. Kapacitetet janë të përfshira pavarësisht nga teknologjia e përdorur, si linjat tradicionale, Ethernet, etj.

Figura 34 – Pjesët e tregut (në volum) në tregun me pakicë për linjat me qira (2017-2022)



Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët nga AKEP, tregu i shitjes me pakicë për linjat me qira duket të jetë i paqëndrueshëm pasi pjesët e tregut të operatorëve rriten dhe ulen pa një model specifik. Kjo paqëndrueshmëri mund të shkaktohet ose nga volumet e ulëta të lidhjeve në treg (maksimumi 4 528 lidhje në 2022) dhe/ose nga çështjet që lidhen me cilësinë e të dhënave. Në çdo rast, sipas të dhënave të disponueshme, One Albania është operatori kryesor i linjave me qira me pakicë me një pjesë tregu që varion nga 42% në 62% gjatë periudhës 2017-2022.

Vlen të përmendet se linjat me qira të One Albania janë kryesisht kombëtare pasi operatori ofron shumë pak lidhje ndërkombëtare. Ndërsa volumet e përgjithshme të lidhjeve ndërkombëtare janë të ulëta (total of 114 connections in 2022), Vodafone is the largest provider providing close to 90% of international leased lines in Albania.

Në terma të numrit të bizneseve të lidhura nga secili operator, Vodafone ishte ofruesi leader në vitin 2022 me 150 klientë, pas një rritje të konsiderueshme krahasuar me 85 klientë që operatorët u ofronin shërbim në vitin 2021 (+76%). Kjo rritje e bazës së pajtimtarëve është reflektuar gjithashtu në rritjen e pjesës së tregut të operatorit në terma të volumit të lidhjeve në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 (Error! Reference source not found.) One Albania ishte operatori i dytë me 105 klientë në vitin 2022, nga 85 klientë që kishte në vitin e mëparshëm (+24%).


Të ardhurat totale të realizuara nga ofertat e linjave me qira me pakicë janë në përgjithësi në rritje. Në fund të vitit 2022, të gjithë operatorët të kombinuar së bashku raportuan LEK 345 milion LEK, nga 234 milion LEK në vitin 2017 (+47%). Operatori incumbent, One Albania, mbetet operatori më i madh në treg, pasi pjesa e tij e tregut në vlerë arriti 57 % në vitin 2022, nga 60 % që ishte në vitin 2017.

Në përgjithësi, luhatja e të dhënave nuk e lejon AKEP-in të nxjerrë një konkluzion specifik në lidhje me statusin e konkurrencës për linjat me qira me pakicë. Megjithatë, asnjë çështje specifike në lidhje me konkurrencën nuk është identifikuar *a priori*, veçanërisht në kuadër të rritjes së evidentuar për Vodafone në vitin 2022.

Pyetje nr.8: A jeni dakort me vlerësimin e konkurrencës në tregjet Broadband me pakicë të kryer nga AKEP në seksionin 3.2.1?

3.2.2 Vlerësimi i konkurrencës në tregjet me shumicë

Figura 35 – Volumet e akseseve bitstream me shumicë të shitura në Shqipëri (2016-2022)



Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët

Volumi i produkteve të aksesit me shumicë që shiten aktualisht në Shqipëri është shumë i ulët. Deri në fund të vitit 2022, kishte gjithsej 578 aksese bitstream, nga 4 633 aksese në vitin 2016. Për sa i përket pjesës së tregut, akseset e shitura nga One Albania përfaqësonin 44% të akseseve totale të shitura në 2022, të cilat përfaqësonin pjesën më të ulët të tregut të operatorit incumbent që nga viti 2016. Me 50% të pjesës së tregut, ASC ishte në vitin 2022 ofruesi më i madh i aksesit në bitstream në Shqipëri.


Për sa i përket akseseve lokale me shumicë, asnjë akses i plotë LLU nuk është shitur nga ndonjë nuk është shitur operator në treg që nga viti 2018.⁵⁴

Për t'i vendosur këto volume në perspektivë, numri total i akseseve në internet me pakicë të shitura në vitin 2022 ishte 586 mijë aksese. Kështu, vetëm 0.1% e akseseve në internet me pakicë u ofruan përmes një oferte me shumicë.

⁵⁴ Ofrohen shumë pak ULL të pjesshme. Sipas të dhënave të operatorëve në vitin 2022, në Shqipëri shiten vetëm 10 aksese.

Të ardhurat totale të gjeneruara nga ofertat me shumicë bitstream janë gjithashtu shumë të ulëta. Në fund të vitit 2022, të gjithë operatorët të kombinuar raportuan vetëm 4,2 milionë lekë, nga 29,2 milionë lekë në vitin 2018.

Figura 36 – Volumet e akseseve të linjave me qira me shumicë të shitura në Shqipëri (2017-2022)



Burimi: Raportet vjetore statistikore të AKEP bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët

Ngjashëm me tregun me pakicë, tregu me shumicë për linjat me qira duket të jetë gjithashtu i paqëndrueshëm. Për sa i përket volumeve, ka pasur një rritje të ndjeshme midis 2017 dhe 2018 pasi numri total i linjave me qira të ofruara në tregun me shumicë arriti në 1 466, nga 651 (+125%). Megjithatë, volumet u ulën me 29% (nga 1 432 në 1 018) midis 2020 dhe 2021 përpara se të rriteshin përsëri në 2022 me 27% për të arritur në 1 291 linja me qira.

Në vitin 2021 dhe 2022, linjat me qira me shumicë përfaqësonin përkatësisht 30% dhe 29% të totalit të linjave me qira me pakicë. Edhe një herë, kjo përqindje është e paqëndrueshme gjatë periudhës së vëzhguar pasi përfaqësonte 21% në 2017, 37% në 2018 dhe 39% në 2020.

Linjat me qira me shumicë të One Albania u ulën si në volum ashtu edhe në pjesën e tregut midis 2017 dhe 2022, pasi ra nga 281 lidhje (43% e tregut) në 166 lidhje (13% e tregut). Përkundrazi, Vodafone u rrit si në volum ashtu edhe në pjesën e tregut duke kaluar nga 170 lidhje (26% e tregut) në 2017 në 450 lidhje (35% e tregut) në 2022.

Për sa i përket numrit të operatorëve të shërbyer përmes tregut me shumicë, Vodafone ishte operatori kryesor me 55 operatorë-klientë në vitin 2022 pas një rritje të ndjeshme nga vetëm 5 operatorë-klientë në 2021. Abissnet është ofruesi i dytë më i madh me 23 operatorë-klientë në vitin 2022 (nga 17 në 2021) dhe One Albania është ofruesi i tretë më i madh me 22 operatorë-klientë në vitin 2022 (në rënie nga 27 në 2021).

Pyetje nr.9: A jeni dakort me vlerësimin e konkurrencës në tregjet Broadbad me shumicë të kryer nga AKEP në seksionin 3.2.2?

3.2.3 Identifikimi i operatorëve me një fuqi të ndjeshme në treg (FNT)

Në përputhje me udhëzimet për FNT të Komisionit Evropian, për të përcaktuar nëse një treg me shumicë e justifikon futjen ose mbajtjen e një rregullimi ex-ante, autoriteti rregullator kombëtar duhet të përcaktojë nëse tregu(t) themelor i shitjes me pakicë është (janë) potencialisht konkurrues në mungesë të rregullimit me shumicë, i bazuar në një gjetje të fuqisë së ndjeshme të tregut, të vetëm ose të bashkuar, dhe si rrjedhim nëse ndonjë mungesë e konkurrencës efektive është e qëndrueshme⁵⁵.

Për këtë qëllim, AKEP analizoi nëse, në mungesë të rregullimit me FNT në tregjet e identifikuar me shumicë, mund të shfaqet rreziku i dëmtimit të konsumatorit për shkak të mungesës së konkurrencës qoftë në tregun e shitjes me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë familje, qoftë në tregun me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë së biznesit.

3.2.3.1 Asnjë dëm i konsumatorit nuk është identifikuar për shkak të mungesës së konkurrencës në rast të heqjes së rregullimit FNT në tregjet me shumicë në rrjedhën e sipërme të tregut me pakicë për shërbimet broadband për përdoruesit familjare

Siç tregohet në seksion 1.11, volumi i akseseve të shitura në tregun me shumicë në Shqipëri është shumë i ulët. Në të vërtetë, pavarësisht disponueshmërisë së një aksesit të rregulluar nga One Albania, akseset në bitstream u ulën nga 4 633 aksese në 2016 në vetëm 578 aksese në vitin 2022. Përveç volumeve kaq të ulëta, One Albania nuk është më ofruesi kryesor i akseseve bitstream me shumicë në Shqipëri. Për më tepër, kërkesa për aksese LLU u zhduk nga tregu që nga viti 2018. Pavarësisht mungesës së përdorimit të produkteve të rregulluara, është zhvilluar një konkurrencë e bazuar në infrastrukturë.

Për të zgjeruar rrjetet e tyre, operatorët shqiptarë ndërtojnë rrjetin e tyre duke përdorur infrastrukturën e tyre, madje edhe për pjesët me kapital më intensiv në rrjet (d.m.th., infrastrukturën fizike lokale) ku ata mbështeten kryesisht në tubacionet dhe shtyllat e tyre të ndërtuara, të financuara nga secili operator me vete ose bashkërisht nëpërmjet marrëveshjeve të investimeve të përbashkëta⁵⁶.

Si i tillë, duke pasur parasysh zhvillimet e sektorit që nga vendimi i fundit i analizës së tregut në 2016 (shih **Seksioni 1**), AKEP gjykon se të dy tregjet e aksesit me shumicë në nivel lokal dhe qendror luajnë një rol shumë të vogël, nëse ka, në zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike në Shqipëri. Prandaj, heqja e rregullimit ex-ante nga këto tregje nuk ka të ngjarë të çojë në dëmtim të konsumatorit ose të pengojë zhvillimin e konkurrencës në tregun e shitjes me pakicë për shërbimet broadband fikse për kategorinë familje.

⁵⁵ Burimi: “Udhëzimet e Komisionit Evropian për analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së rëndësishme të tregut sipas kuadrit rregullator të BE-së për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike”, recitali 16, lidhja: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52018XC0507\(01\)](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52018XC0507(01)) (qasja e fundit më 23/11/2023)

⁵⁶ Të dhënat e mbledhura nga AKEP nga operatorët tregojnë se volumet e kanaleve (në km) të dhëna me qira nga One Albania operatorëve të tjerë janë në rënie që nga viti 2019, pavarësisht rritjes së rëndësishme të numrit total të akseseve broadband siç tregohet në Figurën 1.

3.2.3.2 Asnjë dëm ndaj konsumatorit nuk është identifikuar për shkak të mungesës së konkurrencës në rast të heqjes së rregullimit me FNT në tregjet me shumicë në rrjedhën e sipërme të tregut me pakicë për shërbimet broadband per kategorine biznes

Megjithëse One Albania ka ende një prani të rëndësishme në tregun me pakicë të linjave me qira, në nivelin me shumicë One Albania nuk është më ofruesi më i madh pasi pjesa e saj e tregut ra në 13% për kapacitetet e dhëna me qira në 2022, nga 43% në 2017. Përveç kësaj, ka operatorë të tjerë që kanë zhvilluar oferta konkurruese me shumicë dhe janë bërë lider në treg, si për nga volumi i aksesëve të shitura ashtu edhe për numrin e operatorëve-klientë të shërbyer.

Ndërsa One Albania ende zotëron rrjetin më të përhapur në Shqipëri, operatorët alternativë nuk duket se varen nga ofertat me shumicë nga operatori incumbent për të konkurruar në nivelin e shitjes me pakicë, pasi në treg u shfaqën oferta konkurruese me shumicë. Ndërsa operatorët alternativë vazhdojnë të ndërtojnë rrjetet e tyre në nivel lokal, veçanërisht në zonat urbane ku aktiviteti ekonomik është i përqendruar dhe shumica e bizneseve me nevoja strikte shërbimi për cilësinë janë zbatuar, operatorët biznes duket se kanë gjetur alternativa ndaj ofertave me shumicë të One Albania. Në këtë mënyrë, konstatohet rënia e vërejtur në volume, pjesëve të tregut dhe në numrin e klientëve për operatorin incumbent që nga analiza e mëparshme e tregut.

Prandaj, sipas AKEP-it, heqja e rregullimit ex-ante në tregun e aksesit me shumicë me cilësi të lartë të ofruar në një vendndodhje fikse nuk ka gjasa të çojë në ndonjë dëm të konsumatorit ose të pengojë zhvillimin e konkurrencës në tregun e shitjes me pakicë për shërbimet broadband fiks për kategorinë e pajtimtarëve biznes .

Pyetje nr.10: A jeni dakort me konkluzionin e AKEP për mungesën e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) në tregjet e identifikuar me shumicë?

3.3 Heqja e detyrimeve ekzistuese ex-ante të vendosura aktualisht për sipërmarrësin One Albania

Nisur nga përfundimi i arritur nga AKEP në rubrikën **3.2.3** lidhur me mungesën e nevojës për të vendosur rregullimin ex-ante në tregun për aksesin lokal me shumicë të ofruar nga vendndodhje fikse, tregu për akses qendror me shumicë i ofruar në një vendndodhje fikse për produktet e tregut të përgjithshëm dhe tregun për akses me shumicë me cilësi të lartë i ofruar nga vendndodhje fikse, AKEP propozon heqjen e detyrimeve rregullatore ekzistuese të vendosura aktualisht për sipërmarrësin One Albania në bazë të vendimit të mëparshëm të analizës së tregut të AKEP në 2016.

Pyetje nr.11: A jeni dakort me konkluzionin e AKEP mbi rëndësinë e heqjes së detyrimeve rregullatore ex-ante të vendosura aktualisht për sipërmarrësin One Albania?

Konkluzione finale

Në këtë dokument, AKEP analizoi zhvillimin kryesor të tregjeve broadband fiks në Shqipëri që nga vendimi i mëparshëm i analizës së tregut në 2016. AKEP vëren se në treg ka pasur një rritje të konsiderueshme pasi numri i akseseve me broadband fiks u dyfishua në harkun kohor të 6 -7 viteve të fundit. Kjo rritje, e karakterizuar nga një hendek i konsiderueshëm midis zonave rurale dhe urbane që vijon ende, vjen nga zhvillimi i konkurrencës së bazuar në infrastrukturë. Në të vërtetë, operatorët alternativë kanë investuar në zhvillimin e rrjeteve të tyre, duke përdorur infrastrukturën e tyre fizike në nivel lokal, për të ofruar shërbimet e tyre. Si rezultat, lidhjet me fibra/FTTH bëhen teknologjia kryesore e aksesit në Shqipëri kundrejt rrjeteve historike të bakrit.

Ndërsa operatorët alternativë zhvilluan rrjetin e tyre, ata u bënë më konkurrues në tregun e shitjes me pakicë pasi pjesa e tregut e operatorëve të konsoliduar në treg, duke përfshirë edhe operatorin inkumbent, vazhdon të ulet. Një tjetër pasojë e rëndësishme e zhvillimit të konkurrencës së bazuar në infrastrukturë është ulja e volumit të lidhjeve të shitura përmes tregut me shumicë. Deri në fund të vitit 2022, rreth 0,1% e shërbimeve të aksesit në internet të shitura në tregun me pakicë u tenderuan përmes një tregu bitstream me shumicë. Edhe për volumin e vogël të akseseve të shitura në tregun me shumicë, shumica shiten nga operatorë alternativë mbi baza komerciale.

Prandaj, pavarësisht pothuajse mungesës së shtrirjes së produkteve të rregulluara, konkurrenca me pakicë është zhvilluar. Si i tillë, heqja e detyrimeve rregullatore ekzistuese nuk ka gjasa të dëmtojë konsumatorin për shkak të mungesës së konkurrencës në rast të heqjes së rregullimit me FNT në tregjet e sipërme me shumicë. Në të njëjtën logjikë, zhvillimi i konkurrencës me pakicë ka ndodhur pavarësisht mungesës së rregullimit në tregjet e tjera me shumicë.

Si i tillë, AKEP propozon:

- **Heqjen e detyrimeve rregullatore ex-ante të vendosura aktualisht për One Albania në tregun e aksesit lokal me shumicë të ofruar në një vendndodhje fikse (WLA);**
- **Heqjen e detyrimeve rregullatore ex-ante të vendosura aktualisht për sipërmarrësin One Albania në tregun e aksesit qendror me shumicë të ofruar në një vendndodhje fikse për produktet e tregut të përgjithshëm (WCA);**
- **Heqjen e detyrimeve rregullatore ex-ante të vendosura aktualisht për sipërmarrësin One Albania në tregun e aksesit me shumicë me cilësi të lartë të ofruar në një vendndodhje fikse (WHQA); dhe**
- **Të mos vendos detyrime rregullatore ex-ante në tregun me shumicë për aksesin pasiv në infrastrukturën fizike ndërurbane.**

Pyetje nr.12: A keni komente të tjera për AKEP në lidhje me analizën e tregjeve broadband me shumicë të propozuara?

Aneks: Modeli Benchmark i rregullimit të tregjeve me shumicë të broadband fiks në Rumani, Mal të Zi dhe Francë

Në kuadrin e analizës së tregut, është e rëndësishme të mbështetemi në atë që është bërë në drejtim të rregullimit në vende të tjera për të nxjerrë mësim dhe për t'i zbatuar ato në rastin e Shqipërisë. Kjo është arsyeja pse ne kemi zgjedhur të vendosim një pikë referimi në lidhje me rregullimet që janë zbatuar në vendet e tjera Evropiane. Prandaj, këto janë vende që kanë kryer një analizë të bazuar në zbatimin e legjislacionit përkatës European dhe transpozimin e tyre në legjislacionin kombëtar (Kodi European i Komunikimeve Elektronike, Direktiva për Reduktimin e Kostos broadband 2014/61/BE dhe rishikimi i saj që nga viti 2020, Rekomandimet dhe udhëzimet e Komisionit, etj.)

Vendet e përfshira në këtë studim janë Rumania, Mali i Zi dhe Franca. Secili prej këtyre vendeve është përzgjedhur për arsye të ndryshme, por bazuar në objektivin e përbashkët të lidhjes me sektorin shqiptar të komunikimeve elektronike.

Rasti i Rumanisë është mjaft atipik pasi është një nga vendet e rralla ku asnjë nga tregjet me shumicë nuk është i rregulluar. Ky është një rast interesant sepse ashtu si në Shqipëri, tregu i telekomunikacioneve fikse karakterizohet nga një mjedis presioni të fortë konkurrues ku operatori incumbent ka më pak fuqi tregu se operatori alternativ kryesor. Ekziston gjithashtu një konkurrencë e zhvilluar e bazuar në infrastrukturë dhe një prani e fortë e operatorëve lokalë. Gjithashtu telekomunikacioni fiks është një shembull i suksesit rumun, ku çmimi i internetit është ndër më të ulët në botë. Vendimi për heqjen e rregullimit është interesant edhe në rastin e studimit tonë në Shqipëri, duke qenë se operatori incumbent sot është i kapërcyer nga operatorë alternativë.

Mali i Zi u zgjodh për arsye shumë të ndryshme. Në fakt janë ngjashmëritë nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik dhe afërsia gjeografike që e bëjnë Malin e Zi një rast studimor interesant brenda kornizës së benchmark. Për më tepër, këto dy vende janë kandidatë për integrim në Bashkimin European, drejtimi i vendimeve politike të këtyre dy vendeve duhet të shkojë në drejtim të atij të BE-së.

Franca u zgjodh për vendosjen e rregullimit gjeografik lokal duke dalluar zona të ndryshme nga dendësia e tyre dhe me një studim të thelluar dhe testimin e 3 kritereve të kryera në tregun fizik të infrastrukturës. Këto analiza janë të rëndësishme për vlerësimin e rregullimit që do të propozohen për Shqipërinë.

Përmbledhje ekzekutive e modelit benchmark

Në kuadrin e analizës së tregut, është e rëndësishme të mbështetemi në atë që është bërë në drejtim të rregullimit në vende të tjera për të nxjerrë mësim dhe për t'i zbatuar ato në rastin e Shqipërisë. Kjo është arsyeja pse ne kemi zgjedhur të vendosim një pikë referimi në lidhje me rregulloret që janë zbatuar në vendet e tjera Evropiane. Prandaj, këto janë vende që kanë kryer një analizë të bazuar në zbatimin e legjislacionit përkatës European dhe transpozimin e tij në legjislacionin kombëtar (Kodi European i Komunikimeve Elektronike, Direktiva për Reduktimin e Kostos në brez broadband 2014/61/BE dhe rishikimi i saj që nga viti 2020, Rekomandimet dhe udhëzimet e Komisionit, etj.)

Vendet e përfshira në këtë studim janë Rumania, Mali i Zi dhe Franca. Secili prej këtyre vendeve është përzgjedhur për arsye të ndryshme, por bazuar në objektivin e përbashkët të lidhjes me sektorin shqiptar të komunikimeve elektronike.

Rasti i Rumanisë është mjaft atipik pasi është një nga vendet e rralla ku asnjë nga tregjet e me shumicë nuk është i rregulluar. Ky është një rast interesant sepse ashtu si në Shqipëri, tregu i telekomunikacioneve fikse karakterizohet nga një mjedis presioni të fortë konkurrues ku operatori aktual ka më pak fuqi tregu se operatori alternativ kryesor. Ekziston gjithashtu një konkurrencë e zhvilluar e bazuar në infrastrukturë dhe një prani e fortë e operatorëve lokalë. Gjithashtu telekomunikacioni fiks është një shembull i suksesit rumun, ku çmimi i internetit është ndër më të ulët në botë. Vendimi për heqjen e rregullimit është interesant edhe në rastin e studimit tonë në Shqipëri, duke qenë se operatori incumbent sot është arritur nga operatorët alternativë.

Mali i Zi u zgjodh për arsye shumë të ndryshme. Në fakt janë ngjashmëritë nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik dhe afërsia gjeografike që e bëjnë Malin e Zi një rast studimor interesant brenda kornizës së modelit benchmark. Për më tepër, këto dy vende janë kandidatë për integrim Evropian, drejtimi i vendimeve politike të këtyre dy vendeve duhet të shkojë në drejtim të atij të BE-së.

Franca u zgjodh për vendosjen e rregullimit gjeografik lokal duke dalluar zona të ndryshme nga dendësia e tyre dhe me një studim të thelluar dhe testin e 3 kriterëve të kryera në tregun fizik të infrastrukturës. Këto analiza janë të rëndësishme për vlerësimin e rregulloreve që do të propozohen për Shqipërinë.

Rumania

1.1 Hyrje

Sipas Raportit të Vendit të Dekadës Dixhitale të EQL-së 2023⁵⁷, i cili shqyrton një sërë kriteresh për transformimin dixhital, konektiviteti është fusha në të cilën Rumania shënon rezultatet më të mira. 96% e familjeve rumune kanë tashmë akses në rrjetet Gigabit/FTTP, shumë mbi mesataren e BE-së (73% për mbulimin VHCN dhe 56% për mbulimin FTTP). Megjithatë, mbulimi 5G qëndron në 27%, shumë poshtë mesatares Europiane prej 80%.

1.1.1 Arsyeja e zgjedhjes së Rumanisë

Përtej ngjashmërive në zhvillim dhe afërsisë gjeografike me Shqipërinë, ajo që motivon praninë e Rumanisë është ngjashmëria e tregut me akses fiks mes këtij vendi dhe Shqipërisë:

- ▶ Ekziston një konkurrencë e fortë e bazuar në infrastrukturë në të dy tregjet e shitjes me pakicë.
- ▶ Tregu në zonat rurale është shumë heterogjen me shumë operatorë lokal si në Shqipëri. Mbi 500 operatorë kishin një rrjet akses fiks në Rumani në vitin 2019⁵⁸.
- ▶ Operatori aktual (Telekom Romania Communications SA) mbante një pjesë relativisht të vogël të tregut në vitin 2019 (19%), që është mjaft afër me pjesën aktuale të tregut të One Albania (21%).

Prandaj, zgjedhja e Rumanisë përcaktohet nga ngjashmëritë e tregut.

⁵⁷ Link : <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/country-reports-digital-decade-report-2023>

⁵⁸ Raporti i Tregut 2020 faqe 72

1.1.2 Tregu dhe rregullatori

Në Rumani, rregullatori quhet ANCOM (Autoriteti Kombëtar i Rumanisë për Menaxhimin dhe Rregullimin e Komunikimeve).

Në Rumani, ndryshe nga vendet e tjera anëtare të BE-së, lideri i tregut për shërbimet e aksesit të internetit broadband në pikat fikse nuk është operatori incumbent, por operatori i rrjetit kabllor me fibra optike dhe koaksial RCS & RDS SA. Kjo e fundit kishte një pjesë tregu prej 52% në mesin e vitit 2019, e ndjekur nga Telekom Romania Communications SA me 19% (përkatësisht 22% nëse marrim parasysh pjesën e kombinuar të Telekom Romania Communications SA dhe Nextgen Communications SRL, që i përket Orange SA në më shumë se 50%). Operatori i tretë është UPC Romania SA, e cila në të njëjtën datë mbante një pjesë tregu prej gati 12%.

1.1.3 Përmbledhje e rregullimit të tregut

Në vitin 2020, ANCOM ka njoftuar se nuk është i nevojshëm asnjë rregullim për tregun me shumicë për shërbimet e aksesit në internet broadband fikse në Rumani. Pozicioni i rregullatorit bazohet në një analizë të zhvillimeve të tregut midis 2015 dhe 2019, e cila arrin në përfundimin se tregu i shitjes me pakicë për shërbimet e aksesit në internet broadband fikse është konkurrues, pa qenë i nevojshëm ndonjë rregullim specifik për tregjet me shumicë të rrjedhës së sipërme. I motivuar nga një përdorim i pakonsiderueshëm i rrjetit lokal të operatorit ekzistues, ANCOM arriti në përfundimin se nuk kërkohet asnjë rregullim në tregjet për akses lokal në një vendndodhje fikse dhe, përkatësisht, në tregun për akses qendror të ofruar në një vendndodhje fikse për produktet e tregut të përgjithshëm.

Autoriteti vazhdon të monitorojë zhvillimet në treg, veçanërisht për shërbimet e aksesit në internet me shpejtësi mbi 100 Mbps. Në vendimin e saj, ANCOM specifikoi se do t'i kushtojë vëmendje të veçantë edhe ndryshimeve gjeografike në strategjitë e çmimeve të operatorëve, për të vlerësuar nevojën për të përcaktuar tregjet përkatëse nën-kombëtare, duke monitoruar ndryshimet potencialisht të rëndësishme që do të kërkonin një përkufizim më të detajuar të tregut të produktit, në veçanti aftësia e operatorëve konkurrues për të konkurruar në mënyrë efektive me RCS&RDS në segmentet e shërbimit të aksesit në internet me shpejtësi të lartë.

ANCOM njoftoi gjithashtu se nuk kërkohet rregullim për shërbimet e aksesit në internet me cilësi të lartë.

1.2 Tregjet 3A & 3B: Akses lokal dhe qendror me shumicë i ofruar nga vendndodhje fikse (2020)

Në draft analizën e tregut të njoftuar, ANCOM konstaton se tregu me pakicë për shërbimet e aksesit në internet broadband fikse është konkurrues dhe për këtë arsye nuk e konsideroi të nevojshme të përcaktojë ose analizojë zyrtarisht tregjet përkatëse me shumicë.

1.2.1 Dimensioni i produktit

ANCOM përkufizon tregun përkatës të produktit në nivel të shitjes me pakicë si treg për ofrimin e shërbimeve fikse të aksesit në internet broadband fikse.

Tregu përfshin ofrimin e shërbimeve asimetrike të aksesit në internet broadband nëpërmjet bakrit, kabllorve koaksiale, kabllorve UTP/FTP, fibrave optike dhe teknologjive me valë,

pavarësisht nga raportet për contention ose shpejtësitë e transmetimit, të ofruara për përdoruesit fundorë (si bizneset ashtu edhe personat fizikë) në vende fikse.

Shumica e përdoruesve gëzojnë shërbime të aksesit në internet me shpejtësi maksimale shkarkimi prej 30 Mbps e lart (84 % e linjave) dhe madje 100 Mbps e lart (72 % e linjave). ANCOM konstaton se tregu karakterizohet nga një zinxhir zëvendësueshmërie, i cili çon në kufizime konkurruese në të gjitha shpejtësitë e transmetimit.

1.2.2 Dimensioni gjeografik

Për sa i përket shtrirjes gjeografike të tregut të shitjes me pakicë, ANCOM e konsideron tregun me dimension kombëtar. Analiza gjeografike e ndërmarrë nga ANCOM, bazuar në veçanti në numrin e rrjeteve të pranishme në bashkitë e ndryshme të vendit dhe shkallën e mbivendosjes ndërmjet rrjeteve të ndryshme tregon se pothuajse në të gjitha bashkitë urbane të paktën tre operatorë kanë vendosur infrastrukturën e tyre, ndërsa në shumë zona rurale, përdoruesit fundorë janë shpesh shumë më të kufizuar për sa i përket zgjedhjes dhe shpejtësive të disponueshme. Megjithatë, rregullatori konsideron se struktura dhe situata konkurruese e tregut rumun ndryshojnë rregullisht dhe se tregu vazhdon të rritet, gjë që e bën të pamundur përcaktimin e kufijve të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm ndërmjet zonave nën-kombëtare. Për më tepër, ANCOM tregon se tarifat e disponueshme në zonat rurale janë mesatarisht të ngjashme me çmimet në pjesën tjetër të vendit.

1.2.3 Operatorët me Fuqi të ndjeshme në treg

ANCOM arrin në përfundimin se asnjë operator nuk ka FNT individuale në tregun me pakicë. Rregullatori arriti në këtë përfundim pasi analizoi një sërë faktorësh, duke përfshirë: pjesën e tregut dhe ecurinë e strukturës së tregut, barrierat për hyrjen dhe zgjerimin, kostot e ulëta të kalimit, kontrollin e infrastrukturës që nuk publikohet lehtë, një shkallë të lartë të inovacionit të produktit dhe diferencimi, dhe kufizimet indirekte konkurruese nga tregjet e tjera, në veçanti aksesit broadband celular.

Në lidhje me pjesët e tregut, ANCOM vëren se në Rumani, lider në tregun e aksesit në internet broadband fikse nuk është operatori incumbent (Telekom Romania Communications), por operatori i rrjeteve kabllore me fibër dhe koaksial, RCS & RDS, i cili ka arritur një pjesë tregu në numrin e lidhjeve prej 52.18% në mesin e vitit 2019, krahasuar me 21.57% për operatorin incumbent. Pjesa e tregut e RCS & RDS është rritur rregullisht (nga 47% në 2015 në 52% në 2019), ndërsa pjesët e tregut të Telekom Romania Communications janë ulur (nga 25% në 2015 në 19% në 2019). Konkurrenti tjetër më i madh është UPC Romania/Vodafone me një pjesë tregu 13.31%, ndërsa operatorët e tjerë zënë së bashku më pak se 13% të tregut.

Pjesa e tregut bazuar në të ardhurat e RCS & RDS është tkurrur midis 2015 dhe 2019 (të dhëna të padeklaruar).

ANCOM citon se volumi i tregut po rritet vazhdimisht, për shumicën e operatorëve të rëndësishëm, duke treguar se tregu është larg ngopjes. Sipas ANCOM, ekziston një kontekst i favorshëm për konkurrencë pasi marrëveshjet tregtare për akses në rrjet janë lidhur midis Orange Romania dhe Telekom Romania Communications dhe midis Vodafone Romania dhe RCS & RDS.

Për sa i përket barrierave për hyrjen dhe zgjerimin, ANCOM konsideron se barriera të tilla janë reduktuar ndjeshëm me kalimin e kohës dhe pritet të jenë më të ulëta gjatë horizontit kohor të analizës, veçanërisht në zonat urbane, ku ANCOM evidenton se kërkesa është mjaft e madhe për të mbështetur shfrytëzimin e rrjeteve me akses të shumëfishtë.

Për sa i përket infrastrukturës së kontrolluar, ANCOM thekson se Telekom Romania Communications zotëron rrjetin fiks me mbulimin më të madh (pothuajse 93% e popullsisë), ndërsa RCS & RDS mbulon 74% të popullsisë. ANCOM thekson gjithashtu praninë në shumë bashki të operatorëve më të vegjël, të cilët kanë një bazë të kufizuar klientësh dhe shtrirje rrjeti, por që kontribuojnë në shkallë të konsiderueshme në konkurrencën në infrastrukturë në shumë pjesë të vendit.

Për më tepër, ANCOM konsideron se ekziston një shkallë e lartë e inovacionit dhe diferencimit të produkteve që dëshmohej nga një gamë e gjerë produktesh, shpejtësi të ndryshme shërbimi dhe oferta të ndryshme që përfshijnë çmime konkurruese. Rregullatori evidenton më tej se tarifat për shërbimet e aksesit në internet të ofruara në vendndodhje fikse kanë qenë mbetur në stanjacion ndërmjet viteve 2015 dhe 2019, ndërkohë që cilësia e shërbimeve është përmirësuar ndjeshëm. ANCOM vlerësoi gjithashtu nëse dy ofruesit kryesorë, RCS & RDS dhe Telekom Romania janë të prirur për të pasur FNT të përbashkët dhe arriti në përfundimin se kriteret për gjetjen e dominancës së bashkuar (p.sh., stimujt e koordinimit, transparenca e tregut dhe mekanizmi parandalues) nuk janë përmbushur.

ANCOM ka evidentuar gjithashtu, në përgjigjen e saj ndaj kërkesës për informacion të Komisionit Evropian, se RCS & RDS kohët e fundit ka marrë kontrollin e asetëve të rrjetit dhe bazës së klientëve të një prej konkurrentëve të saj dhe se ky operacion do të rrisë rrjetin e saj, mbulimin dhe pjesën e tregut, veçanërisht në zonat rurale.

1.2.4 Masat rregullatore

